Republika e Kosovës

# Republika e Kosovës
## Komuna e Kaçanikut

KAÇANIKU

# KOMUNA E JUAJ PËR JU

# VJETARI 2009

## JANAR - QERSHOR




www.komunakacanik.org

Republika e Kosovës

Komuna e Kaçanikut

# KOMUNA E JUAJ PËR JU

# VJETARI 2009

## JANAR - QERSHOR

Korrik 2009

Boton:
Komuna e Kaçanikut

Përmbajtja:
Zyra e Informimit
www.komunakacanik.org

Retushimi profesional:
Klubi i Gazetarëve të Kaçanikut

Shtypi:
Shtypshkronja “ERA” Ferizaj

Shpërndarja falas



*Qytetarë të nderuar,*
*Është kënaqësi imja t'iu informoj se kemi vendosur që sivjet Vjetarin 2009 ta botojmë dy herë brenda vitit. Ky vëllim që e keni në duar e përfshin periudhën 1 janar – 30 qershor, ndërsa vëllimin e dytë, që do të përfshijë periudhën vijuese 1 korrik – 31 dhjetor, do ta keni në duar në fillim të janarit 2010. Kemi vendosur që publikimin e punës dhe aktiviteteve të Komunës ta bëjmë për çdo vit edhe për shkak të mirëpritjes dhe vlerësimit të lartë që ju i keni bërë Vjetarit 2008.*
*Botimi edhe i Vjetarit 2009 bëhet me qëllim të publikimit të punës, aktiviteteve dhe vendimeve të Komunës, ndërsa është edhe në funksion të rritjes së transparencës së Ekzekutivit dhe Legjislativit komunal në raport me ju.*
*Edhe në këtë vëllim të Vjetarit 2009 në mënyrë kronologjike janë përfshirë vetëm punët dhe aktivitetet më me peshë gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore.*
*Mbetemi të hapur për vërejtjet dhe sugjerimet tuaja.*
*Bashkëpunimi i ndërsjellë na bënë më të suksesshëm...*

*Me respekt,*
*Xhabir Zharku,*
*Kryetari i Komunës*

Janar 2009

# 2008-a cilësohet vit arritjesh, gazetarët vlerësohen për raportim korrekt

**3 janar** - Kreu i Komunës, z.Xhabir Zharku, në pritjen e organizuar për gazetarët që raportojnë nga komuna jonë, 2008 e ka cilësuar vit arritjesh të qeverisë komunale, ndërsa gazetarët i ka vlerësuar për raportim korrekt. "Në projekte kapitale me interes për qytetarët janë investuar rreth 3 milionë e 350 mijë euro", ka theksuar kryetari Zharku, pasi i ka numëruar arritjet edhe në rrafshet tjera. Ai ka sqaruar se në këto projekte jo vetëm infrastrukturore, MTPT-ja i ka investuar rreth 2 milionë euro, MASHT-i 550 mijë dhe MAPL-i 100 mijë, ndërsa Komuna 700 mijë euro. "Jam i bindur se më 2009 do të ketë më shumë investime nga ministritë e Qeverisë së Kosovës në Komunën e Kaçanikut", është shprehur kryetari, duke lënë të kuptohet se ka marrë premtime nga disa ministra. Z. Zharku ka nënvizuar se do të investohet shumë edhe në ndërtim shkollash të reja. Si arritje është veçuar edhe instalimi i disiplinës dhe shtimi i efektshmërisë në punë i administratës komunale. Kryetari Zharku i ka falënderuar gazetarët për raportim korrekt edhe në raport me pushtetin komunal. "Ju falënderoj për raportim korrekt, ndërsa dera e zyrës sime do të jetë e hapur për ju edhe në të ardhmen", u ka thënë kryetari gazetarëve të pranishëm.

# Për 153 për qind kapërcehet kuota e planifikuar e tatimit në patundshmëri

**5 janar** - Është kapërcyer për 153 për qind kuota e planifikuar për arkëtim mjetesh nga tatimi në patundshmëri më 2008. "Gjatë periudhës 1 janar - 31 dhjetor janë arkëtuar 191.420 euro ose 153,7 për qind më shumë se kuota e planifikuar me buxhetin e Komunës të vitit fiskal 2008 (75.450 euro)", ka theksuar z.Xhelal Dema, menaxher i Zyrës së përhershme të tatimit në pronë. Ai ka nënvizuar se shuma e arkëtuar për 42,74 për qind e ka kapërcyer edhe atë të faturuar (134.101 euro). Ndërkaq, z.Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, ka thënë se arritjet në këtë rrafsh e kanë futur Komunën e Kaçanikut në mesin e 7 simotrave që pretendojnë të shpërblehen nga USAID-i. "Për arritje në arkëtim mjetesh nga tatimi në patundshmëri më 2008, USAID-i do t'i shpërblejë 5 komuna me nga 45 mijë dollarë", ka thënë z.Vërbani. Sipas tij, komunat përfituese do të obligohen që mjetet e dhuruara t'i shfrytëzojnë për realizim projektesh me interes për tatimpaguesit.



# Kryetari merr pjesë në aksionin për pastrimin nga bora të oborrit të KK-së

**5 janar** - Kreu i komunës, z. Xhabir Zharku, bashkë me stafin e tij dhe nëpunës administrativë, ka marrë pjesë në aksionin, heqjen e borës nga oborri i objektit të KK-së dhe nga rruga hyrëse për në objekt, ndonëse këtë punë ishte dashur ta kryente ndërmarrja e kontraktuar – NPRM "Pastërtia". Kryetari Zharku dhe drejtori i "Pastërtisë" e kanë firmosur një aneks marrëveshje e cila këtë kompani e obligon që të jetë në gjendje gatishmërie me makineritë dhe mjetet tjera për pastrimin e rrugëve nga bora dhe ngricat. Komuna ia ka bërë një pagesë paushallë "Pastërtisë" në shumë prej 4 mijë eurosh, ndërsa për çdo intervenim me kamion për heqjen e borës do të bëjë edhe nga një pagesë prej 35 eurosh për një orë punë dhe prej 50 eurosh për një orë punë me skip.



# Më 2008 janë realizuar 21 projekte kapitale, 3 janë në realizim e sipër

**9 janar** - Më 2008 në Komunën e Kaçanikut janë finalizuar 21 projekte jo vetëm infrastrukturore, nga gjithsej 26 të planifikuara, ndërsa për realizimin e tyre nga buxheti i komunës janë investuar 489.101 euro. "Dy nga projektet e planifikuara për realizim vjet aktualisht janë në procedurë tenderuese, ndërsa 3 janë bartur për realizmi sivjet", ka theksuar z.Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit. Ai ka rikujtuar se Komuna është mbështetur nga 3 ministri të Qeverisë së Kosovës për financimin e 4 projekteve



infrastrukturore të cilat nuk ka mundur t'i realizojë vetë për shkak të buxhetit të limituar. "MTPT-ja i ka alokuar 934.756 euro për asfaltimin e segmentit Kovaçec-Soponicë të rrugës Kaçanik-Doganaj, 871.152 euro për asfaltimin e rrugëve të lokalitetit “Dushkaja” në Kaçanik dhe 200.000 euro për asfaltimin e rrugës Duraj-Gabrricë, ndërsa për realizmin e këtyre projekteve kanë participuar edhe Komuna dhe komunitetet", ka thënë z.Vërbani. Nga këto 3 projekte, vetëm ai Duraj-Gabrricë ishte finalizuar ndërkohë. MASHT-i ndërkaq i kishte dhënë 550 mijë euro për ndërtimin e shkollës së re në fshatin Begracë, ndërsa MAPL-i 100 mijë euro për 3 projekte më të vogla. Drejtori Vërbani ka nënvizuar se në procedurë tenderimi është projekti për hartimin e Planit zhvillimor komunal (PZHK) dhe atij zhvillimor urbanistik (PZHU). "Për hartimin e këtyre planeve nga buxheti i Komunës i vitit fiskal 2008 janë alokuar 67.800 euro", ka saktësuar drejtori Vërbani. Sa i përket projekteve të finalizuar vjet, z.Vërbani i ka veçuar: riparimin e kulimit të QKMF-së në Kaçanik, ndërtimin e Zyrës së vendit në fshatin Doganaj, instalimin e rrjetit të kanalizimit fekal në fshatin Dubravë, shtruarjen me kupëza betoni të rrugës "UÇK" në Kaçanik, asfaltimin e rrugës në fshatin Bob, blerjen e një autoambulance me zero kilometrazh për QKMF-në, etj. Është nënvizuar se shuma mjeteve të investuara për realizim projektesh infrastrukturore vjet ka qenë pakrahasueshëm më e madhe se shumat e viteve pararendëse.

# Futbollisti Shpend Bela shpallet sportist i vitit 2008

**16 janar** - Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës e ka shpallur Shpend Belën, futbollist i KF "Lepenci", sportist të vitit 2008. Në fjalën përshëndetëse në ceremoninë e organizuar me rastin e shpalljes së sportistit të vitit të Komunës së Kaçanikut, nënkryetari i Komunës, z.Heset Loku, ka thënë se KK-ja e ka mbështetur dhe do të vazhdojë ta mbështes zhvillimin e sporteve në komunën tonë, por mundësitë financiare janë të limituara. "Do të dëshironim që të kemi sa më shumë klube sportive të cilat do ta prezantonin Komunën tonë në garat e ndryshme sportive", ka thënë z.Loku. Ndërkaq, KF “Lepenci” e ka nderuar me mirënjohje kryetarin e Komunës, z.Xhabir Zharku, për mbështetjen dhe ndihmën e dhënë këtij klubi.



# Është shpenzuar 94,1 për qind e Buxhetit 2008

**24 jana**r - Programet buxhetore të Komunës së Kaçanikut vjet i kanë shpenzuar 3.285.052 euro ose 94,1 për qind të mjeteve buxhetore në dispozicion (3.494.541 euro). "Të pashpenzuara kanë mbetur 209.489 euro", ka saktësuar z.Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit. Ai ka theksuar se nga totali i mjeteve të pashpenzuara vetëm 15.445 euro kanë përfunduar suficit, ndërsa 147.095 euro janë bartur në buxhetin e sivjetshëm të komunës. "Në Buxhetin e Kosovës janë kthyer vetëm mjetet e pashpenzuara të grandit qeveritar, ndërsa ato të të hyrave vetjake janë bartur në buxhetin e sivjetshëm të Komunës", ka sqaruar z.Vërbani.

# OSBE-ja dhe Komuna përurojnë bibliotekën ligjore

**27 janar** - Znj. Julie Woloshin, shefe e Zyrës së OSBE-së në Kaçanik dhe zëdhënësi i komunës, z. Hajrush Dullovi, e kanë përuruar bibliotekën



ligjore në objektin e KK të Kaçanikut. Është thënë se OSBE-ja ndërkohë do t'i sigurojë të gjitha vëllimet e botuara të Gazetës zyrtare të Kosovës dhe tituj nga fusha e drejtësisë, ndërsa komuna inventarin. "Biblioteka do të jetë edhe në dispozicion të qytetarëve e gazetarëve", ka nënvizuar z. Dullovi.

## "Data Gis-Consulting" do t'i hartojë planet zhvillimore komunale

**28 janar** - Byroja projektuese "Data Gis-Consulting", me seli në Prishtinë, do ta hartojë Planin zhvillimor komunal (PZHK) dhe atë zhvillimor urban (PZHU). Z. Zeqir Selmani, menaxher i Zyrës së prokurimit, ka thënë se firma "Data Gis Consulting" ka marrë më shumë pikë nga komisioni për vlerësimin e ofertave, ndërsa edhe oferta e saj financiare ka qenë më e lirë se e 3 firmave të tjera pjesëmarrëse në tender. Ai ka bërë të ditur se "Data..." ka ofertuar me çmim prej 65.994 eurosh.



# Kryetari takon pjesëtarët e TMK-së të pa sistemuar në FSK

**29 janar** - Kryetari i komunës, z. Xhabir Zharku, është takuar me pjesëtarët e TMK-së të cilët kanë mbetur pa u sistemuar në FSK. "Ne jemi të njoftuar me këtë proces, por kemi shpresuar të jetë më pak i dhimbshëm", u ka thënë kryetari të pranishmëve. Kryetari z.Zharku ka deklaruar të jetë thellë i prekur me mospranimin e tyre në FSK. "Mendoj se pjesëtarët e TMK-së nga komuna jonë thjesht janë anashkaluar, ndërsa kur e them këtë e kam parasysh profesionalizmin, cilësitë dhe angazhimet tuaja në të shkuarën", ka deklaruar z. Zharku. Ndërkaq, pjesëtarët e TMK-së të pa sistemuar në FSK i kanë shprehur mirënjohjen e tyre kryetarit Zharku dhe KK të Kaçanikut për vlerësimin e angazhimit të tyre në TMK dhe për gatishmërinë e artikuluar për t'i ndihmuar ata brenda mundësive që ka Komuna.



# Legjislativi e fuqizon vendimin e kryetarit për 8-katëshen në pronë komunale

**31 janar** – KK i Kaçanikut e ka fuqizuar vendimin e kreut të Komunës, z.Xhabir Zharku, me të cilin ndërmarrjes ndërtimore"Çlirimtarët", me seli në Kaçanik, i lejohet ndërtimi i një objekti të përzier afarist-banesor (P+8) në një sipërfaqe në pronësi të KK-së. Opozita ndërkaq ka pasur vërejtje lidhur me ligjshmërinë e vendimit. "Vendimin për ndërtimin e tetëkatëshes nga NN 'Çlirimtarët' e kam marrë për t'i shkurtuar procedurat burokratike të tenderimit dhe për të mbështetur ndërmarrjet lokale", ka deklaruar kryetari Zharku. Ai u ka thënë këshilltarëve të pranishëm në mbledhje se ndërmarrja e sipërpërmendur është pajtuar që 20 për qind të hapësirës së objektit në vijë vertikale t'i përkas Komunës, ndërsa përparësi për blerje lokalesh afariste të kenë pronarët e lokaleve me leje të përkohshme që gjenden në lokacionin ku do të ndërtohet tetëkatëshja.



## Shkurt 2009

# Kryetari takon stafin e Drejtorisë së Emergjencës dhe Shërbimeve Publike

**2 shkurt** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, në vazhdën e takimeve me personelet e drejtorive komunale, ka takuar stafin e Drejtorisë së Emergjencës dhe Shërbime Publike. "Kam vendosur që të bisedoj më të gjithë punëtorët e Komunës", ka thënë kryetari Zharku. Sikurse në takimet e mëhershme me stafet e drejtorive tjera, z. Zharku ka thënë se drejtorët e drejtorive i kanë hartuar raportet vjetore të punës për vitin 2008, ndërsa ka rikujtuar se KK-ja e ka miratuar edhe raportin e Ekzekutivit komunal për vitin 2008. "Raporti është vlerësuar i suksesshëm", ka nënvizuar kryetari Zharku. Ai ka thënë se KK-ja i ka miratuar edhe planet e punës të drejtorive për vitin 2009. "Sivjet do të kërkojmë disiplinë dhe angazhime të shtuara në mënyrë që të ngritet cilësia e shërbimeve për qytetarët tanë", ka thënë kreu i Komunës.



# Komuna vendos "policë të shtrirë" në rrugët Kaçanikut

**4 shkurt** - Komuna ka nisur vendosjen e "policëve të shtrirë" në rrugët e Kaçanikut. "Këso barriera kemi vendosur në disa pika të rrugës së asfaltuar që shtrihet përmes fshatit Kaçanik i Vjetër dhe në rrugën 'Emin Duraku' në Kaçanik", ka theksuar Rushan Ceka, drejtor i Drejtorisë së Emergjencës dhe Shërbimeve Publike. Projekti është financuar nga KK-ja. "'Policë të shtrirë do të vendosim kudo ku vlerësohet e nevojshme", ka theksuar z.Ceka. Është rikujtuar se ndërkohë është duke u bërë edhe shenjëzimi vertikal i rrugëve të Kaçanikut. "Në plan e kemi edhe shenjëzimin horizontal të rrugëve", ka thënë drejtori Ceka.



# Dorëzohet certifikata e parë me logon, vulën dhe mbishkrimin e Republikës së Kosovës

**4 shkurt** - Shërbimi i ofiqarisë i KK-së ka nisur me dorëzimin palëve të certifikatave dhe dokumenteve të tjera me logon, vulën dhe mbishkrimin e Republikës së Kosovës. "Jeton (Sh.) Shurdhani është qytetari i parë kaçanikas që ka marrë certifikatë lindjeje me logon, mbishkrimin dhe vulën e institucioneve të Republikës së Kosovës", ka thënë z.Murtez Mema, shef i Shërbimit të ofiqarisë.



# QKMF-ja në Kaçanik ia dhuron tre inkubatorë foshnjash QKUK-së

**6 shkurt** - QKMF "Dëshmoret e lirisë" në Kaçanik ia ka dhuruar Klinikës Obstetrike Gjinekologjike në Prishtinë tre inkubatorë për zhvillim foshnjash të lindura para kohe dhe 4 shtretër. Dokumenti i dorëzim pranimit është firmosur nga z.Nejazi Luma, drejtor i QKMF-së dhe depoisti i KOGJ-it, z. Agim Deliu. Është thënë se inkubatorët kanë qëndruar të pashfrytëzuar që nga montimi i tyre, më 2000. "QKMF-së në Kaçanik inkubatorët ia kanë dhuruar mjekët spanjollë të shoqatës “Mjekët pa kufij", ka rikujtuar drejtori Luma. Ideja për t'ia dhuruar inkubatorët Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, zyrtarëve të QKMF-së u kishte lindur pasi nga raportime mediash kishin marrë vesh se Klinika Obstetrike Gjinekologjike nuk ka numër të mjaftueshëm inkubatorësh.



# Pesë vjet pas ndërtimit të trotuarit të "Ismail Rakës", nis bashkimi i tij para kafenesë "Oxa"

**7 shkurt** - Pesë vjet pas ndërtimit të trotuarit të rrugës kryesore të qytetit "Ismail Raka", ka nisur bashkimi i tij para kafenesë "Oxa". Për shkak të një kontesti pronësor deri tashti trotuari aty ka qenë "i këputur". Ndërtimi i kësaj pjese të trotuarit do të realizohet në gjerësinë e njëjtë me dy anët ekzistuese të tij. Z.Bekim Troni, drejtor i Urbanizmit, ka konfirmuar se punimet tashmë kanë filluar. Ky projekt, sipas z.Troni, është kontraktuar në vlerë prej rreth 3.500 eurosh. Lidhur me këtë projekt, z. Fatos Koxha zyrtar i Urbanizmit, ka sqaruar se do të bëhet pastrimi i përroskës e cila kalon përreth dhe nën rrugë, pastaj do të ndërtohet një urë kaluese me dimensione sa për t'i absorbuar ujërat e përroskës dhe do të bëhet shtrimi i sipërfaqes së trotuarit me kupëza betoni. Realizimin e këtij projekti e ka kërkuar kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku. Vjet, në fund të dhjetorit, Komuna pati arritur një marrëveshje me pronarin e kafenesë "Oxa" për prishjen e një muri të vogël dhe lirimin e hapësirës së verandës për ndërtimin e trotuarit, e cila edhe pati ndodhur.



# Komuna shpëton nga mbyllja zyrën e "Handikosit"

**9 shkurt** - Qendra e "Handikosit" në Prishtinë nuk i ka alokuar buxhet për vitin 2009 zyrës së saj në Kaçanik, ndërsa KK-ja ka vendosur t'i dalë në ndihmë. Znj. Elmihane Krasniqi, koordinatore e "Handikosit" në Kaçanik, ka theksuar se Zyra në Kaçanik do të vazhdojë të jetë e hapur edhe sivjet falë ndihmës së KK të Kaçanikut. "Është miratuar kërkesa e 'Handikosit' për mbështetjen e aktiviteteve të kësaj OJQ-je me 2.990 euro", ka pohuar z.Misim Sopa, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Drejtori Sopa ka sqaruar se mjetet janë siguruar nga fondi i subvencioneve i DSHMS-së. Mjetet e alokuara nga KK-ja janë vlerësuar të mjaftueshme për disa nga aktivitetet e projektuara për realizim sivjet nga "Handikosi" i Kaçanikut. "Me këto para do të realizojmë disa nga aktivitetet që kanë të bëjnë me vlerësim të gjendjes së personave me aftësi të kufizuara, organizim takimesh me fokus grupe, edukim joformal dhe shënim datash të rëndësishme për anëtarët e shoqatës sonë", ka theksuar koordinatorja Krasniqi.

# Komuna shpalos agjendën e Ditës së Pavarësisë

**14 shkurt** - Në bazë të agjendës së prezantuar nga Komuna e Kaçanikut, kremtimi i përvjetorit të parë të Pavarësisë së Kosovës konsiderohet të jetë organizimi më i mobilizuar në historinë e kremtimeve të festave kombëtare, shtetërore e komunale në komunën tonë. Vargu i aktiviteteve të larmishme festive - kulturore, artistike, zbavitëse, sportive etj., nën patronazhin e kryetarit të Komunës, z. Xhabir Zharku, do të nis me "grimimin" kuqezi të hapësirave frekuentuese publike jo vetëm në qytet. Sipas skenarit të




prezantuar nga z.Hajrush Dullovi, zëdhënës i Komunës, fillimi i kremtes do të shënohet me stolisjen e qytetit, ndërkohë që është paraparë edhe “qepja” e katër mbishkrimeve të mëdha: një te Guri i Shpumë dhe tri në rrugët e qytetit (një te kalaja, një tjetër në rrugën “Ismail Raka”, një pranë pallatit të kulturës “Xheladin Kurtaj” dhe një mbishkrim më i vogël brenda pallatit me urimin: “Gëzuar Pavarësia e Kosovës”). Po ashtu, ka shtuar z.Dullovi, përgjatë urës në magjistrale te Guri i Shpumë do të vendosen 84 flamuj që simbolizojnë dëshmorët e Komunës së Kaçanikut, sikundër edhe te muri mbrojtës në dalje të qytetit, te Ura e Konakut, te parku i qytetit etj. Me moton “Për ambientin e Pavarësisë”, do të organizohet aksion për pastrimin e

mjedisit në qytet, në fshatra dhe në  të gjitha shkollat dhe institucionet. Dita festive e 1-vjetorit të Pavarësisë do të nisë me një program festiv të fëmijëve, për të vazhduar me parakalimin unazor në rrugët e qytetit, pastaj me koncert për fëmijë dhe qerasjen e tyre me një desert të titulluar “Me ëmbëlsirën e Pavarësisë”. Në mesditë do të bëhen homazhe te Varrezat e Dëshmorëve, ndërsa më pas do të hapet ekspozita me fotografi kolektive “Dita e Pavarësisë”. Më pas do të mbahet akademi solemne, ku përveç fjalëve të rastit do të shpërblehen edhe nxënësit fitues në garën e esesë më të mirë “Gëzimi i Pavarësisë”, ndërsa do të shfaqen edhe promovime në fushën e valleve dhe këngëve. Zëdhënësi Dullovi ka nënvizuar se kremtimi i ditës më të madhe historike për Kosovën, në Kaçanik, do të përmbyllet me një koncert të madh në ambient të hapur në të cilin programet e tyre do t'i shfaqin: SHKA “Gryka e Kaçanikut”, SHKA “ Shqiponja”, rok grupe, solistë etj, si dhe grupe artistike nga Bllaca, Shkupi, Tetova dhe Dibra. Do të luhet edhe finalja e turneut në futboll të vogël. Përgatitjet për shënimin e këtij përvjetori në Kaçanik kanë filluar më 3 shkurt, me rastin e themelimit të këshillit organizativ, i udhëhequr nga kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharkut, në të cilin janë përfshirë strukturat relevante të institucioneve lokale dhe shoqëria civile.

# Dekor festiv në vigjilje të Ditës së madhe të Pavarësisë

**14 shkurt** - Flamuj kombëtarë dhe të shtetit të Kosovës, aty-këtu edhe të SHBA-së, NATO-s dhe BE-së, sikundër edhe mbishkrime me moton: "Urime Pavarësia", kanë mbushur rrugët e qytetit të Kaçanikut, në prag të shënimit të përvjetorit të parë të Pavarësisë së Kosovës. Për ta bërë këtë ditë edhe më madhështore, në organizim të Kuvendit Komunal, 84 flamuj kombëtarë, që simbolizojnë 84 dëshmorët e komunës sonë, janë vendosur edhe përskaj urës mbi të cilën kalon magjistralja, te Guri i Shpumë.



# Homazhe dëshmorëve në Ditën e Pavarësisë

**17 shkurt** - Një 1-vjetorin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, përfaqësues të institucioneve komunale kanë bërë homazhe te Varrezat e Dëshmorëve. Krahas kryetarit të Komunës, z. Xhabir Zharku dhe kryesuesit të Kuvendit Komunal, z.Xhelal Gashi, në nderimin për dëshmorët ka marrë pjesë edhe përfaqësuesi i Komunës së Dibrës së Madhe (Maqedoni), z Petrit Paçuku, pastaj kryetari i Degës së OVL të UÇK-së, z.Ejup Runjeva, si dhe përfaqësues strukturash tjera komunale dhe qytetarë të shumtë nga komuna jonë.



# Zbulohet tabela me mbishkrimin e ri para objektit të KK-së

**17 shkurt** - Në prani të strukturave komunale dhe të një numri nxënësish e qytetarësh, për nder të përvjetorit të parë të pavarësisë së Kosovës është zbuluar në hyrje të objektit të Komunës tabela me mbishkrimin "Komuna e Kaçanikut". Kjo tabelë e cila e ka stemën e shtetit të Kosovës dhe emblemën e Komunës së Kaçanikut, është zbuluar nga kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku dhe z.Ejup Runjeva, kryetar i Degës së Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së në Kaçanik.



# Fëmijët parakalojnë me pelerinat “Urime Pavarësia”

**17 shkurt** - Ndër aktivitetet e shumta që u zhvilluan në shënim të 1-vjetorit të pavarësisë ishte edhe parakalimi unazor i fëmijëve rrugëve të qytetit, të veshur me pelerina me mbishkrimin “Urime Pavarësia”, e të përcjellë me muzikë lëvizëse festive. Më pas është shfaqur edhe një koncert për fëmijë në pallatin e kulturës “Xheladin Kurtaj”.



# Imazhet e Ditës së Pavarësisë ekspozohen në përvjetorin e parë të saj

**17 shkurt** - Në hollin e pallatit të kulturës "Xheladin Kurtaj" është hapur një ekspozitë fotografish me imazhe nga kremtimi i Ditës së Pavarësisë së Kosovës në Kaçanik, një vit më parë. Ekspozitën e ka hapur drejtori i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, z.Azem Guri, ndërsa ka përshëndetur z.Arif Mulaku, njëri nga fotografët i cili ka ekspozuar në këtë eveniment pjesën më të madhe të imazheve festive të para një viti. Po ashtu, me moton: "Marshi i flamurit të pavarësisë", janë ekspozuar edhe disa fotografi të një grupi prej katër vetash, të cilët e patën ngritur flamurin kombëtar në majën e Lybetenit, më 17 shkurt 2008.



# Turne futbolli për Ditën e Pavarësisë

**17 shkurt**- Në 1-vjetorin e Pavarësisë, drejtoria e Arsimit dhe Kulturës ka organizuar edhe turneun tradicional në futboll të vogël për meshkuj e femra "Kupa e Pavarësisë së Kosovës". Në turne morën pjesë 32 ekipe, ndërsa sistemi i garave ishte eliminues. Në gjysmëfinalen e meshkujve u takuan : Lepenci – Rinia islame dhe Kadetët e Lepencit - Mani. Për vendin e tretë luajtën Rinia islame- Kadetët e Lepencit, ndërsa fitore shënoi Rinia Islame me rezultat 4:1. Shpërblimet dhe mirënjohjet i ndau z.Hajrush Kurtaj, ish-epror i lartë i UÇK-së. Ndërkaq, në finale u takuan Mani – Lepenci, ndërsa Lepenci shënoi fitore me rezultat 4:1. Kupa e Pavarësisë së Kosovës i takoi ekipit të Lepencit, ndërsa shpërblimet, mirënjohjet dhe kupën i ndau z.Xhabir Zharku, kryetar i Komunës. Vendi i dytë në kategorinë e meshkujve i takoi ekipit të Manit, ndërsa shpërblimet dhe mirënjohjet i ndau z.Heset Loku, nënkryetar i Komunës. Në këtë turne morën pjesë edhe 4 ekipe të femrave : Kosova nga Prishtina, Malisheva, Vizioni nga Ferizaj dhe Diti Sport nga Kaçaniku.



# Njëvjetori i Pavarësisë shënohet edhe me akademi solemne

**17 shkurt** - Në përvjetorin e parë të pavarësisë së Kosovës është organizuar edhe një akademi solemne në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve komunale dhe qytetarë të shumtë jo vetëm nga komuna jonë. Një fjalë rasti e ka mbajtur kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, i cili ka vlerësuar se nuk ishte lehtë për të ardhur te kjo Ditë e Madhe. Kryetari Zharku ka rikujtuar Lidhjen e Prizrenit, periudhën e LDB-së, lëvizjen për flamur 1968, vitet e 80-ta, duke i cilësuar momente që i kanë paraprirë kurorëzimit të lirisë së Kosovës me luftën e UÇK-së. Ndërkaq z.Berat Luzha, deputet i Parlamentit të Kosovës, 17 shkurtin dhe 28 nëntorin i ka cilësuar si data që do të shkruhen me shkronja të arta në historinë tonë kombëtare. Në emër të veteranëve të luftës së UÇK-së, ka përshëndetur z.Ejup Runjeva, kryetar i OVL-së. Ka përshëndetur edhe z.Petrit Paçuku, përfaqësues i Komunës së Dibrës së Madhe të Maqedonisë, i cili tha se po ua sjell në Kaçanik përshëndetjet e të gjithë dibranëve për pavarësinë e Kosovës. "Meritat për shtetin e Kosovës u takojnë dëshmorëve, prandaj në emër të dibranëve lavdi u qoftë dëshmorëve", është shprehur z.Paçuku. Në përvjetorin e parë të pavarësisë së Kosovës, OVL-ja e Kaçanikut i ka nderuar me mirënjohje "post mortum" veteranët e UÇK-së të cilët janë ndarë nga jeta pas luftës. Është shfaqur edhe një program artistik. Pjesë e akademisë solemne ishte edhe ndarja e çmimeve nga Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës nxënësve të shkollave të mesme, autorë të eseve më të mira me temë: "Gëzimi i Pavarësisë".



# Kremtimi i Ditës së Pavarësisë përmbyllet me koncert të madh

**17 shkurt** - Kremtimi i Ditës së Pavarësisë në komunën tone është përmbyllur me një koncert të madh të mbajtur në ambient të hapur, para pallatit të kulturës "Xheladin Kurtaj". Mijëra qytetarët e pranishëm i argëtuan solistë nga Kaçaniku, Shkupi, Dibra dhe Tetova.



# Nën patronazhin e kryetarit të Komunës do të shënohen të gjitha betejat e UÇK-së

**20 shkurt** - Nën patronazhin e kryetarit të Komunës, z.Xhabir Zharku, sivjet do të shënohen të gjitha betejat e zhvilluara në territorin e komunës sonë nga Brigada 162"Agim Bajrami" e UÇK-së. Tubimet do t'i organizojë Këshilli organizativ komunal, bashkë me nënkëshillat e lokaliteteve të komunës dhe OVL-në. "Sivjet është 10-vjetori i rënies së dëshmorëve, prandaj është nder që sivjet të organizojmë tubime përkujtimore dinjitoze për të nderuar veprën heroike të të gjithë dëshmorëve", ka deklaruar kryetari Zharku.



# Kryetari takon gjeneralin Kudusi Lame

**20 shkurt** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, ka pasur në një takim miqësor me gjeneralin Kudusi Lame. Z. Zharku ka thënë të ketë kënaqësinë të takoj gjeneralin Lame i cili gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë i angazhuar në cilësinë e ushtarakut të lartë profesional. Kryetari Zharku ka nënvizuar se ai ka qenë në qendër dhe në vijën e parë të ngjarjeve ushtarake-politike gjatë luftës çlirimtare, ndërsa shpesh ka zbritur edhe në terrenin e luftës duke dhënë një kontribut të madh në organizimin dhe konsolidimin e radhëve të UÇK-së. Në shenjë nderimi dhe mirënjohjeje, kryetari Zharku ia ka dhuruar gjeneralit Lame emblemën e Komunës së Kaçanikut.



# Komuna ia përsërit MSH-së kërkesën për rihapjen e sanatoriumit

**23 shkurt** - Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale e KK të Kaçanikut ia ka përsëritur Ministrisë së Shëndetësisë kërkesën për rihapjen e spitalit për të sëmurët nga TBC-ja. "Në fillim të shkurtit, në MSH e kam riadresuar kërkesën për rihapjen e sanatoriumit në Kaçanik", ka theksuar z.Misim Sopa, drejtor i DSHMS-së, pasi ka rikujtuar se një kërkesë e njëjtë e bërë një vit më parë ka mbetur pa përgjigje. Drejtori Sopa ka thënë se objekti ekzistues i plotëson të gjitha kushtet për spital. "Objekti i ish-sanatoriumit i ka 1.200 metra katrorë hapësirë, ndërsa gjendet në një sipërfaqe të gjelbëruar me rreth 4 hektarë", ka thënë ai. Rihapja e spitalit ishte kërkuar edhe për shkak të faktit se objekti gjendet në pikën ku takohen klima kontinentale me atë mesdhetare. "Pikat ku takohen këto dy klima janë shumë shëruese për të sëmurët nga sëmundjet respiratore, e sidomos për ata që vuajnë nga TBC-ja e eshtrave", ka nënvizuar z. Sopa. Ai ka rikujtuar se për shkak të klimës me efekt rehabilitues, në objektin e propozuar për spital dikur ka funksionuar sanatoriumi për të sëmurët jo vetëm nga TBC-ja e eshtrave. "Sanatoriumi ka qenë funksional nga



vitet e 30-a të shekullit XX e deri në vitet 70-a të po atij shekulli", ka thënë drejtori Sopa. Pas përfundimit të luftës në Kosovë objekti i ish-sanatoriumit është shfrytëzuar nga TMK-ja.

## Kreu i Komunës takon gjeneralët e "Bondsteel"-it

**27 shkurt** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, ka pasur një takim miqësor me dy gjeneralë të KFOR-it amerikan, z.Kay dhe z.Jones. Generali Kay i ka thënë z.Zharku se i ka përfunduar mandati i komandantit të Brigadës Shumëkombëshe të Lindjes, ndërsa e ka njoftuar me pasardhësin e tij, gjeneralin Jones. Kryetari Zharku e ka njoftuar gjeneralin Jones me Komunën e Kaçanikut, duke ia shpalosur të dhënat karakteristike dhe resurset. Ndërkaq, duke e falënderuar për kontributin, kryetari Zharku i ka thënë gjeneralit Kay se ju e keni kryer shkëlqyeshëm një mision shumë të rëndësishëm. Kryetari Zharku mysafirëve ua ka dhuruar emblemën e Komunës së Kaçanikut.



# Legjislativi miraton njëzëri kthimin nën autoritetin e Komunës të KRUK "Bifurkacionit", Njësia në Kaçanik

**27 shkurt** - KK i Kaçanikut njëzëri e ka miratuar propozim vendimin e ekzekutivit komunal për kthimin nën autoritetin e Komunës të kompanisë rajonale të ujit dhe kanalizimit "Bifurkacioni", Njësia në Kaçanik. Hartuesit e propozim vendimit kanë deklaruar se ai është në harmoni me Ligjin për vetëqeverisjen lokale, ndërsa kanë nënvizuar se KRUK"Bifurkacioni", Njësia në Kaçanik, ka performancë të mirë financiare. "Propozim vendimi është në harmoni me pikën (f) të nenit 17 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, ndërsa Njësia në Kaçanik e 'Bifurkacionit' i arkëton deri në 70 për qind të mjeteve të faturuara", ka theksuar z.Rushan Ceka, drejtor i Drejtorisë së Emergjencës dhe Shërbimeve Publike. Njësia në Kaçanik e "Bifurkacionit" ka operuar si ndërmarrje e menaxhuar nga KK i Kaçanikut deri më 2003, me emërtimin NKUK "Lypeteni".



# Përkujtohet dëshmori Hetem Hasaj

**28 shkurt** - Me një manifestim të mbajtur në vendin e rënies, në fshatin Gajre, është përkujtuar dëshmori Hetem Hasaj, i cili ra heroikisht më 28 shkurt 1999 në një ballafaqim frontal me forcat policore serbe. Në këtë manifestim morën pjesë përfaqësues të institucioneve komunale, familjarë të dëshmorëve, bashkëluftëtarë të dëshmorit dhe qytetarë të tjerë. Me pietet për dëshmorin Hasaj ka folur z.Xhabir Zharku, kryetar i Komunës, ndërsa kujtime për dëshmorin Hetem Hasaj ka evokuar z.Muharrem Baftiu, bashkëluftëtar i tij. Në këtë tubim ka folur edhe z.Ejup Runjeva, kryetar i Degës së Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së në Kaçanik, ndërsa në emër të familjes së dëshmorit të pranishmit i ka falënderuar për pjesëmarrje Mexhid Hasaj. Në fund të këtij manifestimi është shfaqur një program artistik, ndërsa pranë pllakës përkujtimore të



Mars 2009

# Epopeja e UÇK-së" organizohet edhe në Kaçanik

**5 mars** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, duke u bazuar në nenet 13, 17 (r) dhe 58 (b) të Ligjit të vetëqeverisjes lokale, ka marrë vendim për organizimin e manifestimit "Epopeja e UÇK-së", saktësisht "Natës së zjarreve". Manifestimi do të organizohet më 7 mars, ndërsa ndezja e zjarreve do të bëhet te Varrezat e Dëshmorëve me fillim në orën 18:00.

## Kryetari takon shefin rajonal të Zyrës Civile Ndërkombëtare

**5 mars** – Kreu i Komunës, z. Xhabir Zharku, në zyrën e tij është takuar me shefin e Zyrës Civile Ndërkombëtare me seli në Gjilan, z. Oliver McCoy. Mysafiri i ka thënë kryetarit se desha t'ju takoj që të njoftohemi dhe njëherësh t'ju ftoj të prezantoni në ceremoninë e hapjes zyrtare të



Zyrës Civile Ndërkombëtare në Gjilan, në njërën nga ditët e muajit prill. Z. McCoy ka theksuar se mision yni është të përcjellim zbatimin e Planit të Ahtisaarit edhe nëpër komuna. Kryetari Zharku, pasi e ka falënderuar për vizitën, i ka thënë z.McCoy se është i mirëseardhur në Kaçanik. “Kosova tashmë është shtet, ndërsa jeni të mirëseardhur këtu që t'i ndajmë përvojat me ju dhe të trajtojmë çështje të caktuara”, i ka thënë mysafirit kryetari Zharku.

## Urimi i kryetarit për mësuesit, në ditën e tyre

**7 mars** – “Në këtë ditë feste, 7 marsi –Dita e mësuesit, të gjithë ne i kujtojmë mësuesit tanë të dashur që patëm me vite, ata që na mësuan e edukuan, ata që u bënë pjesë e pandarë e jetës dhe suksesit tonë, që nuk kursyen asgjë për t'i pajisur nxënësit me dije, kulturë dhe edukatë. Mësuesit tanë i qëndruan besnik misionit fisnik të arsimimit e edukimit të brezave edhe atëherë kur regjimi okupues serb mendoi se do ta ndalë ABC-në shqipe duke mbyllur shkollat në Kosovë, por populli ynë hapi zemrat dhe shtëpitë që u bënë shkolla. Shumë mësues u dënuan e u gjykuan, por asnjëherë nuk u gjunjëzuan në rrugën e diturisë dhe lirisë së atdheut, duke sakrifikuar edhe jetën. Ata ne sot i kujtojmë me respekt! Sot jemi në 122-vjetorin e hapjes së shkollës së parë shqipe, më 7 mars 1887 në Korçë, festën e mësuesit dhe 11-vjetorin e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që madhështojnë këtë datë të shënuar historike; jemi në përvjetorin e betejave të 5,6 dhe 7 marsit të vitit 1998 dhe rënies heroike të komandantit legjendar të UÇK-së, Adem Jashari, betejave të sakrificës sublime për lirinë dhe pavarësinë e vendit. Gëzuar festën tuaj të dashur mësues! Lavdi komandantit legjendar Adem Jashari dhe gjithë dëshmorëve të rënë për Liri dhe Pavarësi!”

Xhabir Zharku,
Kryetar i Komunës

# Ndizen zjarre në “Natën e zjarreve”

**7 mars** - Me ndezjen e zjarreve te Varrezat e Dëshmorëve, edhe në Kaçanik, në kuadër të manifestimit "Epopeja e UÇK-së", u shënua "Nata e zjarreve". Pos qytetarëve të shumtë, morën pjesë edhe udhëheqës komunalë, familjarë të dëshmorëve dhe ish-ushtarë të UÇK-së. “Është shumë me rëndësi që kjo datë e rëndësishme është bërë traditë dhe festohet nga të gjithë qytetarët e Kosovës, në shenjë përkujtimi dhe respekti për të gjithë ata të cilët ranë për lirinë e vendit tone. Madhështia e këtij manifestimi qëndron në faktin se gjaku i dëshmorëve nuk shkoi huq, por u kurorëzua me pavarësinë e Kosovës, e cila është pritur shumë vite dhe nga shumë gjenerata, ndërsa ne ishim gjenerata më me fat dhe sot po e gëzojmë lirinë dhe shtetin Kosovës', ka theksuar kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku.





# Përkujtohen 4 dëshmorët e Betejës së 8 marsit

**8 mars** - Dëshmorët Murat Lika, Qani Luma, Raif Koraqi dhe Osman Luma janë përkujtuar në 10-vjetorin e rënies. “Beteja e 8 marsit 1999 dhe të tjerat me radhë ishin ngjarje heroike jo vetëm për Kaçanikun, por edhe për Kosovën”, ka thënë kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, në tubimin përkujtimor të organizuar në fshatin Shtrazë. Ai ka nënvizuar se nëpërmjet këtyre tubimeve përkujtimore duam t'u japim një mesazh gjeneratave të reja duke u treguar se si arriti liria, ndërsa merita kryesore për këtë u takon dëshmorëve dhe të gjithë luftëtarëve të lirisë. “Përkujtimi dhe nderimi më i madh për dëshmorët sot është puna dhe angazhimi ynë për ta ndërtuar shtetin e Kosovës”, ka theksuar kryetari Zharku. Organizatorët e këtij tubimi përkujtimor fjalën ia kanë dhënë edhe z.Berat Luzha, deputet i Kuvendit të Kosovës, z.Elham Bunjaku (OVL) dhe ish-pjesëtarëve të UÇK-së, zotërinjve Zimer Luma e Vehbi Koraqi. Është shfaqur edhe një program artistik nga nxënës të shkollave të Ivajës, Shtrazës dhe Gllobоçicës. Para se të mbahej tubimi, te pllaka me emrat e këtyre 4 dëshmorëve, në Ivajë, janë vendosur kurora lulesh.



# Drejtori i DAK-ut takon këshilltaren e Bankës Botërore

**10 mars** –Drejtori i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, z.Azem Guri, është takuar me znj. Rosalind Levaçic, këshilltare e Bankës Botërore, e cila e monitoron procesin e zbatimit të formulës financiare në nivel shkollash. Komuna e Kaçanikut është njëra nga tri komunat e Kosovës që nga 1 janari i këtij viti ka filluar të zbatojë pilotprojektin lidhur me vetëmenaxhimin e buxheteve në tri nivelet shkollore (parafillor, fillor dhe të mesëm). Drejtori Guri ka thënë se zbatimi i kësaj formule do të jetë model për shkollat tjera të Kosovës që pritet të fillojnë të vetëmenaxhojnë me buxhetet nga 1 janari i vitit 2010.



# Komuna kërkon nga KEK-u largimin e shtyllave të tensionit të lartë te "Ismail Raka"

**18 mars** -Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike i ka bërë thirrje KEK-ut që sa më shpejtë t'i largojë shtyllat e rrjetit elektrik të tensionit të lartë që ndodhen në trotuarin e rrugës "Ismail Raka". Në shkresën të cilën DESHP-i, nëpërmjet kryetarit të Komunës, z.Xhabir Zharku, ia ka adresuar distriktit të KEK-ut në Ferizaj, vlerësohet se rrjeti elektrik 10 kilovoltësh është tejet i rrezikshëm për kalimtarët të cilët e frekuentojnë jashtëzakonisht shumë këtë rrugë. Në letrën të cilën e ka nënshkruar z.Rushan Ceka, drejtor i DESHP-it, një kopje e së cilës i është adresuar edhe ministres së Energjetikës dhe Minierave, znj.Justina Pula-Shiroka, kërkohet nga KEK-u marrja e masave të menjëhershme për largimin e këtyre dy shtyllave kapriatë. Këto dy shtylla janë vendosur para lufte, ndërsa rruga "Ismail Raka" bashkë me trotuaret në dy anët e saj është ndërtuar më 2002.



# Prezantohet Strategjia e Zhvillimit Lokal

**18 mars** - Është bërë prezantimi i Strategjisë së Zhvillimit Lokal (SZHL), e hartuar nga Grupi Lokal i Veprimit (GLV). Nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku, e ka çmuar lart punën dhe angazhimin e GLV-së për hartimin e SZHL-së dhe e ka falënderuar Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian, projektin LDS, sikundër edhe Ministrinë e



Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për mbështetjen e zhvillimit rural. Prezantimin e draftstrategjisë e ka bërë z.Nuhi Provoliu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë, ndërsa ka nënvizuar se prioritete të saj janë bujqësia, infrastruktura rurale, menaxhimi i tokës bujqësore etj. Ndërkaq, znj.Albana Raka, nga sektori privat, ka shpaluar aspektet e zbatimin të kësaj strategjie. Është

zgjedhur edhe Bordi drejtues i GLV-së. Në përbërjen e këtij bordi janë zgjedhur 8 veta, 4 nga sektori publik dhe 4 nga ai privat. Me Bordin drejtues të GLV-së do të udhëheqin: z. Nuhi Provoliu, kryetar, znj.Hidajete Guri, nënkryetare e parë nga sektori publik dhe z.Bekim Koxha, nënkryetar i dytë nga sektori privat. Është miratuar edhe statuti i GLV-së, sikundër edhe emërtimi "Syri i Sharrit" për këtë grup.

## Në Gjilan, kryetari takon të sëmurët kaçanikas që i nënshtrohen dializës

**19 mars** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, në Spitalin e Gjilanit ka vizituar të sëmurët kaçanikas që i nënshtrohen dializës aty. Kryetari ka shprehur brengën e tij për këtë kategori të sëmurëve që detyrohen të udhëtojnë në Spitalin e Gjilanit, ndërsa ka artikuluar nevojën urgjente që këtyre pacientëve t'iu mundësohet trajtim mjekësor sa më afër.



# Fadil Guri emërohet udhëheqës i personelit të Komunës së Kaçanikut

**19 mars** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, duke u bazuar në nenin 66.5 të Ligjit të vetëqeverisjes lokale dhe nenit 8.2 e Urdhëresës administrative 2003/02 për zbatimin e Rregullores 2001/36 të shërbimit civil, sikundër edhe në procedurat e rekrutimit, selektimit dhe intervistimit të zbatuara nga Komisioni rekrutues dhe intervistues, e ka konfirmuar përzgjedhjen e kandidatit Fadil Guri për pozitën udhëheqës i personelit të Komunës së Kaçanikut. Në konkursin e publikuar për këtë post kanë konkurruar 4 kandidatë, nga të cilët 3 me diploma të fakultetit juridik dhe 1 me diplomë të shkencave politike.



# Në Kotlinë, përkujtohen 14 dëshmorët dhe 15 viktimat civile

24 mars - Në Kotlinë janë përkujtuar përkujtuar 14 dëshmorët dhe 15 civilët e rënë të këtij fshati. Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, folës i parë në tubimin e organizuar përkujtimor, ka thënë se kjo ishte një masakër e paparë, makabre, njëra ndër masakrat më të mëdha që kanë ndodhur në Kosovë. "Kjo masakër duhet të ndriçohet, ndërsa kryesve të saj – militarëve, paramilitarëve dhe policëve serbë - duhet t'u jepet dënimi merituar", ka nënvizuar z.Zharku. Tutje, kryetari Zharku ka thënë se krijimi i shtetit të Kosovës ishte amaneti i dëshmorëve, ndërsa lirinë e ka sjellë gjaku i tyre dhe ndihma e aleatëve, SHBA-së dhe NATO-s. Kryetari ka rikujtuar se në bashkëpunim dhe koordinim po me këta faktorë Kosova është shpallur shtet sovran dhe i pavarur. Nga një fjalë rasti e kanë mbajtur edhe z.Latif Loku (KO) dhe z.Ismajl Elezi (OVL), ndërsa në emër të familjarëve të të rënëve të pranishmit i ka përshëndetur z.Mustafë Loku. Është shfaqur edhe një program artistik, ndërsa lule të freskëta janë vendosur në memorialin e ndërtuar në afërsi të shkollës së fshatit.





# KK-ja, komemoracion për drejtorin e ndjerë të Pallatit të Kulturës

30 mars - KK i Kaçanikut ka mbajtur mbledhje komemorative për të ndjerin Avdulla Malsiu, drejtor e Pallatit të Kulturës, i cili humbi jetën në aksident trafiku. Pas një minute heshtje, familjarëve, miqve dhe bashkëpunëtorëve të të ndjerit ngushëllime u kanë shprehur kreu i komunës, z.Xhabir Zharku dhe kryesuesi i KK-së, z.Xhelal Gashi, ndërsa fjalën e rastit e ka mbajtur z.Ibush Vishi, përgjegjës për kulturë në Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës. "Avdulla Malsiu, 55-vjeçar, baba i 5 fëmijëve, ka qenë drejtor i pallatit të kulturës “Xheladin Kurtaj” që nga përfundimi i luftës në Kosovë, ndërsa në sektorin komunal të kulturës ka punuar nga viti 1977", ka thënë ai. Për të ndjerin, z.Vishi ka thënë të ketë qenë njeri me kredo të fortë morale e profesionale, mendjehapur e racional në vendimmarrje. Vdekja e tij është cilësuar humbje jo vetëm për familjen. Për shkak të vdekjes tragjike të drejtorit të Pallatit të Kulturës, mbledhja e thirrur e legjislativit komunal për këtë ditë është shtyrë për një ditë tjetër. Në aksidentin e trafikut që ka ndodhur në fshatin Doganaj të Kaçanikut, jetën e ka humbur edhe kushëriri i Avdullahut, Sakip Malsiu (73). Varrimi i të ndjerëve është bërë sot pasdite në varrezat e fshatit Dubravë.



# Prill 2009

# Autostrada përshkon edhe Kaçanikun

2 Prill - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, ka takuar në zyrën e tij znj. Fjolla Ferizin, përfaqësuese e kompanisë franceze “EGIS BCEOM International”, kompani fituese e tenderit për hartimin e projektit të autostradës Prishtinë-Hani Elezit, si dhe z. Naim Kelmendin, përfaqësues i Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit. Në këtë takim, përfaqësuesi i MTPT-së z. Naim Kelmendi e ka njoftuar kryetarin me rrjedhën e deritanishme të projektit të autostradës, duke saktësuar se tani më është definuar vija e segmentit deri në Gërlicë, ndërsa ka shtuar se nga ky lokalitet e deri në Han të Elezit, ministria ka dy opsione të cilat do të përcaktohet në ndërkohë. Ndërkaq, kryetari Zharku ka thënë se për ne është shumë me rëndësi që autostrada do të



kalojë nëpër territorin e komunës së Kaçanikut dhe përmes Grykës së Kaçanikut deri në Han të Elezit. Ne e dimë se më herët ka pas edhe opsione tjera, por për fat të mirë tonin kjo nuk do të ndodh, sepse në të kundërtën Kaçaniku do mbetej si një zorrë qorre, ka thënë kryetari Zharku. Përfaqësuesja e kompanisë së sipërpërmendur ka kërkuar nga Komuna jonë të dhënat ekzistuese nga infrastruktura nëntokësorë si: rrjeti i ujësjellësit, kanalizimit, të dhënat kadastrale dhe ato gjeologjike e pedologjike...

## Aplikojnë 303 ndërmarrës për grantin e "CARLUX"-it

3 Prill - Organizata CARITAS nga Luksemburgu, e mbështetur nga Qeveria e këtij vendi ka filluar pilot projektin "Zbutja e varfërisë nëpërmjet përkrahjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme". Përfitues të këtij projekti do të jenë gjithsej 25 biznese nga komuna e Kaçanikut, prej tyre 19 biznese fillestare dhe 6 biznese ekzistuese. Në konkursin e shpallur të kësaj organizate, për të përfituar nga këto fonde kanë aplikuar 303 përfaqësues biznesesh apo pretendentë për të hapur ndërmarrje të reja në komunën tonë. Varësisht nga idetë e bizneseve që do të prezantohen dhe atraktiviteti i projekteve, numri i granteve të dhuruara mund të rritet apo edhe të jetë më i vogël se 25. Vlera e përgjithshme e grantit të CARITAS-it të Luksemburgut për këtë projekt është 62 mijë euro. Organizata "CARLUX" në Kosovë e ka selinë në Ferizaj.



# Komuna shpall katër zona industriale në hapësirë 18 hektarësh

3 Prill - KK ka marrë vendim për caktimin e vijave ndërtimore në rrugën Bob-Doganaj, duke filluar nga "Përroi i Kukajve" e deri te ura mbi lumin Lepenc, e njohur si "Ura e Banovinës" në fshatin Soponicë, dhe përgjatë rrugës "Fusha e Pajtimit" - Kaçanik i Vjetër - Begracë e deri te kryqëzimi me rrugën Gërlicë - Viti, ndërsa sipas vendimit distanca e ndërtimeve eventuale nuk guxon të jetë më pak se 10 metra nga rruga në këto dy akse rrugore. Gjatësia e rrugës Bob-Doganaj ku kufizohen ndërtimet është rreth 8 kilometra, aq sa pothuaj është edhe rruga "Fushë e Pajtimit"-kryqëzim i rrugës së Vitisë. Legjislativi lokal po ashtu ka miratuar vendimin për shpalljen e katër zonave industriale në këtë komunë: zona industriale në fshatin Begracë në sipërfaqe 7.2 hektarë, ajo në fshatin Doganaj me 5.4 hektarë, zona industriale në fshatin Gërlicë e Epërme me 1.1 hektarë si dhe zona industriale në Kaçanik të Vjetër (4.1 hektarë), e që gjithsej përbëjnë hapësirën e rreth 18 hektarëve. Në këtë seancë, me disa vërejtje është miratuar edhe raporti vjetor financiar për vitin 2008, raport i përpiluar konform Udhëzimit administrativ 2008/13 dhe i përfunduar më 31 dhjetor të vitit të kaluar.



# Jeta dhe vepra e dëshmorit Reshat Shehu përjetësohet në libër

4 Prill - "Reshat Shehu - dëshmor i brezit të artë", është libri monografik i autorit Latif Nallbani, i cili u përurua në Kaçanik, ndërsa i kushtohet dëshmorit të kombit, Reshat Shehut, të rënë heroikisht në Betejën e Rakocit, më 9 prill 1999. Në këtë përurim kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, është shprehur se falë gjakut të dëshmorëve, punës së madhe të të gjithë brezave ne sot jemi këtu, falë edhe sakrificës së Reshatit me shokë ne sot po e gëzojmë shtetin tonë të Kosovës. Për dëshmorin Reshat Shehu ka folur ish-nënkryetari i KK-së, z. Hebib Shehu. Ndërkaq, znj. Sevdije Shehu ka shprehur dëshirën që një ditë të gjithë të rënët për liri t'i shohim bashkë në një libër, t'i nderojmë të gjithë, sepse ata meritojnë t'u përkulemi çdo herë. Kujtime për dëshmorin e përjetësuar në libër ka evokuar z. Jakup Krivanjeva, shok i fëmijërisë së Reshatit. Në vazhdim të këtij përurimi të mbajtur në Pallatin e Kulturës "Xheladin Kurtaj", ka folur autori i librit "Reshat Shehu - dëshmor i brezit të artë", z. Latif Nallbani, i cili është shprehur se e kam ndier si të nevojshme për të shkruar për një personalitet të kthesave të mëdha, siç ishte Reshati. Në fund të pjesës foljore ka përshëndetur të pranishmit znj. Melihate Shehu, motra e dëshmorit. Më pas është shfaqur një dokumentar për dëshmorin Reshat



# Përkujtohen dëshmorët dhe martirët e 9 Prillit 1999

9 Prill - Mijëra qytetarë nga komuna e Kaçanikut e më gjerë, kanë përkujtuar të enjten në dhjetëvjetorin e rënies 28 dëshmorë të kombit dhe 32 martirë të luftës, të cilët ranë më 9 prill 1999 në Rakoc dhe Lagje të Re. Manifestimet janë mbajtur në të dy lokacionet, ndërsa kanë folur përfaqësues të jetës politike e institucionale, bashkëluftëtarë të dëshmorëve etj. Fjalën e rastit në manifestimin përkujtimor në Rakoc e ka mbajtur z. Besnik Bajra, pjesëmarrës i kësaj beteje, i cili ka vlerësuar se përpjekjet për liri e të drejta njerëzore e kombëtare janë instinkti dhe vetëdija më lavdishme e popullit. Tubimin e ka përshëndetur kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i cili ka vlerësuar se për arritjen e lirisë së Kosovës përveç sakrificës sublime të dëshmorëve dhe luftës së UÇK-së, ka kontribuuar edhe ndërhyrja e aleatëve të Kosovës, ndërsa



ka përkujtuar se luftën, përpjekjen dhe sakrificat i mbajti mbi supet e veta populli. Tubimin e ka përshëndetur edhe , z. Misim Sopa, ndërsa në emër të veteranëve të luftës ish-koloneli i TMK-së, z. Hajrush Kurtaj, ish-zëvendëskomandant i Brigadës 162 të UÇK-së "Agim Bajrami". Më pas është shfaqur një program kulturor-artistik, ndërsa pranë pllakës së të rënëve janë vendosur lule të freskëta dhe janë bërë homazhe edhe te Varrezat e Dëshmorëve të Kaçanikut. Për t'i nderuar në dhjetëvjetorin e rënies dëshmorët dhe martirët e 9 prillit, në orët e vona të pasdites është mbajtur një akademi përkujtimore. Në akademi ka fol kryetari i komunës z, Xhabir Zharku, ndërsa në emër të qeverisë ka përshëndet z. Lutfi Zharku, ministër i Tregtisë dhe Industrisë si dhe deputeti z. Berat Luzha. Ky përvjetor jubilar është organizuar nën patronazhin e kryetarit të Komunës, z. Xhabir Zharkut.

## Kaçaniku përfiton 45 mijë dollarë nga grandi i USAID-it

10 Prill - Komuna e Kaçanikut ka arritur që arkës buxhetore sivjet t'i shtojë edhe ca para të cilat nuk i kishin planifikuar për vitin 2009. Komuna jonë ka përfituar 45 mijë dollarë nga një grant i USAID-it, për suksesin e arritur në realizimin e të hyrave vetjake në vitin 2008. Për vitin 2008 janë arkëtuar 546.662 euro, për dallim nga viti 2007 ku janë grumbulluar 316.800 euro, ose 72 për qind më shumë në vitin 2008 se sa një vit më herët, ka theksuar z. Fikri Vërbani, drejtor i Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit në Kaçanik. Sipas tij, kontributdhënës më të mëdhenj në këtë aspekt janë: tatimi në pronë nga i cili janë arkëtuar 191.979 euro ose 153 për qind më shumë se në vitin 2007 (75.644

euro), pastaj taksa e shfrytëzimit të tokës ndërtimore 37.069 euro ose 179.8 për qind më shumë se më 2007 (13.248 euro), ngarkesat vjetore të bizneseve 29.254 euro ose 55.8 për qind më shumë se më 2007 (18.782 euro), taksa rrugore komunale 28.700 euro... Drejtori Vërbani ka sqaruar se jo vetëm kësaj here që kemi përfituar nga USAID-i, por që nga viti 2004, prej se Qeveria e Kosovës ka filluar të ndajë grantin stimulues për arkëtimin e tatimit në pronë, Komuna jonë për çdo vit ka qenë përfituese e këtij grandi.



# Përkujtohen dëshmorët dhe martirët e rënë në Sllatinë

13 Prill - Me një manifestim përkujtimor në Sllatinë janë përkujtuar në dhjetëvjetorin e rënies dëshmorët e UÇK-së dhe 13 martirët e kësaj ane. Në këtë tubim fjalën e rastit e ka mbajtur z. Kemajl Murseli, veteran i luftës. Në emër të Komunës tubimin e ka përshëndetur z. Xhabir Zharku, kryetar, i cili ka vlerësuar se pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës na mbetet ta ndërtojmë, forcojmë dhe zhvillojmë shtetin tonë. Në emër të veteranëve të luftës tubimin e ka përshëndetur z. Ejup Runjeva, kryetar i OVL-së, ndërsa në emër të familjeve të dëshmorëve ka përshëndetur z. Xhabir Elezit, vëlla i dëshmorit Hysen Elezit, i cili bashkë me dëshmorët Shaban Elezi dhe Ramadan Xhokli u përkujtuan të hënën në dhjetëvjetorin e rënies. Në këtë manifestim është shfaqur edhe një program artistik, ndërsa pranë pllakës përkujtimore janë vendosur kurora me lule si dhe janë bërë homazhe te Varrezat e Dëshmorëve.



## Përparim Hajdari lë postin e drejtorit të DAP-së

15 Prill - Drejtori i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme të komunës tonë, z. Përparim Hajdari ka dhënë dorëheqje nga ky post, ndërsa më pas Komuna edhe ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës. Z. Përparim Hajdari ka paraqitur dorëheqje me shkrim nga kjo detyrë për arsye të vazhdimit të studimeve jashtë vendit. Aktvendimi për përfundimin e marrëdhënies së punës së z. Përparim Hajdarit është realizuar në përputhje me nenin 62.2 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale.

## Luksemburgu ndihmon me 90 mijë euro Biçecin dhe Kaçanikun e Vjetër

15 Prill - Nëpërmjet një programi për zhvillimin e komunitetit, organizata e Luksemburgut CARITAS sivjet ka shtrirë programet e



zhvillimit në dy fshatra të komunës së Kaçanikut - në Biçec dhe në Kaçanik të Vjetër. Për të promovuar këtë program i cili parasheh ndihmë financiare për projekte të ndryshme, z. Rifat Krasniqi, koordinator për zhvillimin e komunitetit i Caritasit të Luksemburgut, është takuar me banorët e fshatit Biçec. Caritasi i Luksemburgut ka ofruar nga 45 mijë euro për secilin nga këto dy fshatra. Sipas tij, 20 mijë euro do të investohen në lëmin e infrastrukturës, 10 mijë euro në sektorin social-ekonomik dhe po aq në atë për rini e fëmijë, si dhe 5 mijë euro për ambient. Z. Krasniqi ka sqaruar se në projektet të cilat do të përzgjidhen të realizohen, komuniteti duhet të participojë me së paku 11 mijë euro. CARITAS- i Luksemburgut ka vënë në dispozicion këto mjete për komunitetin, ndërsa për destinimin e tyre do të vendosin banorët fshatit Biçec, përkatësisht të Kaçanikut të Vjetër. Programi i kësaj organizate ka për qëllim edhe që të angazhojë vetë banorët në identifikimin e nevojave për investime dhe hulumtimin e ideve për vetëzhvillimin e këtij fshati, zhvillimin e kapaciteteve për zgjidhjen e problemeve dhe përmirësuar jetën e qytetarëve. Në emër të banorëve të fshatit Biçec, z. Shabi Dullovi, administrator, e ka falënderuar CARITAS-in e Luksemburgut dhe Qeverinë e këtij vendi, për ndihmën dhe përkrahjen financiare dhe i ka siguruar se angazhimi, kontributi dhe ndihma e banorëve lokalë do të jetë prezentë në realizimin e objektivave të përbashkëta.

# Dokumentar për kontributin suedez në Kosovë

15 Prill – Njëri nga producentët e filmit suedez, z. Mikael Sjomark është duke përgatitur një film dokumentar për Kosovën, ndërsa në fokus të kamerës së tij është Kaçaniku. Z. Sjomark është shprehur gjatë xhirimeve se ka ardhur për të bërë një dokumentar të shkurtër,



nëpërmjet të cilit populli suedez do të informohet me të arriturat dhe investimet e bëra në Kosovë dhe Kaçanik, si dhe për t'i identifikuar sferat në të cilat suedezët mund t'i orientojnë ndihmat në të ardhmen. Ekipi i këtij filmi dokumentar në këtë kuadër do të nxjerr në ekran edhe një intervistë të shkurtër me kryetarin e Komunës, z. Xhabir Zharkun. Ky i fundit, nëpërmjet ekipit të këtij xhirimi ka falënderuar popullin suedez për ndihmën e ofruar në rindërtimin e vendit, investimet në projektet e ndryshme, por edhe për ngrohtësinë e pritjes dhe strehimit të popullit tonë në Suedi.

## Komuna merr masa ndaj borxhlinjve të vet

16 Prill - Autoritetet komunale ua kanë vënë drynin pesë lokaleve afariste në rrugën “Emin Duraku” në Kaçanik, për shkak të moskryerjes së obligimeve financiare ndaj qirasë së Komunës. Ndërkaq, kësaj mase i kanë shpëtuar pronarët e 10 lokaleve afariste, të cilët kanë shlyer së paku 25 për qind të borxhit të përgjithshëm të tyre ndaj Komunës, ashtu siç ka kushtëzuar Komuna. Aksioni është mbështetur nga Policia e Kosovës.

## Gati përmbushet shuma e planifikuar e të hyrave nga tatimi në pronë

18 Prill - Zyrës së tatimit në pronë i duhen vetëm edhe 17.465 euro për ta realizuar qind për qind planin i arkëtimit të këtij burimi vetjak financiar për vitin 2009. Nga të hyrat e tatimit në pronë, deri më 18 prill janë arkëtuar 61.035 euro, ka thënë z. Xhelal Dema, menaxher i Zyrës



së tatimit në pronë, sipas të cilit nga ky burim me buxhet janë planifikuar të mblidhen për tërë vitin 78.500 euro. Sipas menaxherit Dema, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2008, gjatë këtij tre mujori e gjysmë janë mbledhur 233 për qind më shumë mjete nga ky tatim(vitin e kaluar deri më 18 prill janë arkëtuar 27.473 euro). Ndërkaq, sipas z. Fikri Vërbani, drejtor i DFEZh-së, rritja e shkallës së arkëtimit të këtij tatimi është si rezultat se qytetarët janë duke i kuptuar gjithnjë e më shumë si të dobishme pagesën e taksave ndaj shtetit dhe se ata janë bindur se me të vërtetë këto mjete janë duke iu kthyer qytetarëve nëpërmjet projekteve kapitale.

## Në dhjetëvjetorin e rënies përkujtohen dëshmorët Feriz e Xhevdet Guri

22 prill - Në vendin e rënies, në afërsi të fshatit Gorancë të Hanit Elezit, në kufirin Kosovë-Maqedoni, janë përkujtuar dëshmorët Feriz Guri-Komandant Shpata dhe Xhevdet Guri, të rënë më 22 prill 1999.

Manifestimi përkujtimor u organizua nën patronatin e kryetarit të komunës së Kaçanikut, z. Xhabir Zharku dhe në bashkëpunim me OVL-UÇK-së dega në Kaçanik. Në vendin e rënies së dëshmorëve, pranë pllakës përkujtimore, fjalë rasti ka prezantua kryetari i komunës, z. Xhabir Zharku. Kryetari, z. Zharku me këtë rast tha se sot jemi në 10 vjetorin e rënies së dëshmorëve Feriz Guri-Komandant Shpata dhe Xhevdet Guri, jemi në 10 vjetorin e betejave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por jemi edhe në 10 vjetorin e fitoreve të mëdha të çlirimit të atdheut.

Dëshmorët ne po i përkujtojmë çdo vit dhe do t'i përkujtojmë gjithherë, sepse ata e dhanë më të shenjtën, jetën e tyre, dhe falë

luftës, gjakut dhe heroizmit të tyre, ne sot po e gëzojmë lirinë dhe pavarësinë e vendit, por ne kemi ende shume punë për të bërë, tha kryetari,z. Zharku.

Në këtë manifestim, në emër të familjeve të dëshmorëve, ka përshëndet, Shqipërim Guri. Komanda e Brigadës 162 "Agim Bajrami", Feriz Gurin e emëroi Komandant të Kompanisë III (tretë) të Batalionit I (parë), ndërsa pas rënies së tij, Batalioni I (parë) mori emrin e dëshmorit Feriz Guri.

Në vendin e rënies së dy dëshmorëve u vendosën lule të freskëta, ndërsa u bënë homazhe edhe te Varrezat e dëshmorëve.



# Debatohet rreth Planit të veprimit për integrime evropiane

23 Prill - Në Pallatin e Kulturës “Xheladin Kurtaj” është mbajtur debati me temën: “Promovimi i Planit të veprimit për partneritet evropian dhe roli i komunave në procesin e integrimeve evropiane”, debat i cili është organizuar nga Zyra Komunale për Integrime Evropiane, e në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësues të Qeverisë së Kosovës, ata të komunës së Kaçanikut, medieve, shoqërisë civile, OJQ-ve, përfaqësues të grupeve te interesit etj. Nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku, ka vlerësuar me këtë rast se procesi i integrimit evropian është një proces i vazhdueshëm për të cilin duhet mjaft punë e veçanërisht roli i pushtetit lokal është i pazëvendësueshëm, për faktin se integrimi duhet filloj nga baza. Nënkryetari Loku ka premtuar se përkushtimi dhe angazhimi i Komunës në procesin e Planit të veprimit për partneritet evropian do të jetë i madh. Një ekspoze të shkurtër të projektit e ka



paraqitur znj. Hidajete Guri, ushtruese e detyrës së zyrtares së Zyrës Komunale të Integrimeve Evropiane në Kaçanik. Në vazhdim të këtij debati të mbajtur të enjten në Pallatin e Kulturës "Xheladin Kurtaj", panelistët kanë dëgjuar interesimin e të pranishmëve dhe u janë përgjigjur pyetjeve të tyre.

## Legjislativi vendos për ndarjen e mjeteve për shujtën e mantelbardhëve

27 Prill - KK ka marrë vendimin për lejimin e mjeteve financiare për kompensimin e shujtës së punëtorëve të shëndetësisë në Kaçanik. Ky vendim është përkrahur nga të gjithë këshilltarët komunalë, ndërsa shuma e mjeteve të caktuara për këtë destinim është 13.952 euro. Këtij vendimi i ka paraprirë marrëveshja e kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi dhe kryetarëve të komunave, vitin e kaluar, ndërsa para kësaj marrëveshje kryeministri Thaçi iu pat premtuar punëtorëve shëndetësorë nga 44 euro shtesë për secilin nga tre muaj e fundit të



vitit të kaluar, gjë që ndikoi në ndërprerjen e grevës së mantelbardhëve. Në këtë seancë legjislativi ka shqyrtuar dhe miratuar edhe raportin e realizimit të mjeteve buxhetore për periudhën janar-mars 2009.

## Festivali i këngës popullore për fëmijë "Kaçaniku 2009"

30 Prill - Znj. Adelina Bela, interpretuesja e këngës së titulluar "E kujtoj atë takim", është fituese e Festivalit të tretë të këngës popullore për fëmijë "Kaçaniku 2009", i cili është mbajtur tri ditë rresht. Fituese e çmimit të dytë të festivalit është znj. Ardiana Vishi, kurse vendin e tretë e ka zënë znj. Blerta Shehu me këngën "Unë një fik e ti një fik". Çmimin e publikut e ka fituar Edona Kamishi, e cila është shoqëruar nga motra e saj Ilmija në interpretimin e këngës "Me lule të bukura". Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës- organizatore e festivalit, fituesve u ka ndarë nga një pikturë. Juria e festivalit të tretë përbëhej nga Sylejman Haxhiu, Ruzhdi Xhini dhe Tefik Shehu. Në këtë festival kanë konkurruar 40 këngëtare amatore të shkollave të ciklit të mesëm të ulët, të cilat janë paraqitur në dy netët e para, ndërkohë që 20 më të mirat janë përzgjedhur për natën finale. Si zakonisht konkurrentet fillimisht janë përzgjedhur nga një audicion.



Maj 2009

# Themelohet Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi

4 Maj - Komuna ka konstituuar Këshillin Komunal të Sigurisë në Bashkësi, i cili është themeluar në përputhje me Udhëzimin administrativ nr. 08/2009 të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të asaj të Administrimit të Pushtetit Lokal. Me rastin e formimit të këtij këshilli, kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, ka thënë se KKSB-ja është organ konsultativ për çështje të sigurisë dhe ka një përfaqësim më të gjerë. Sipas Udhëzimit administrativ, KKSB-ja duhet t'i mbajë së paku 10 takime në vit, ndërsa udhëhiqet nga kryetari i Komunës. Përfaqësues të këtij këshilli janë: z. Xhabir Zharku- kryetar i Komunës, Togeri Jaser Jaha- u.d. i komandantit të Stacionit të Policisë, Rushan Ceka- drejtor i Drejtorisë së Emergjencës dhe Shërbimeve Publike, Fatmir Çaka (Ekipi Veprues për Siguri në Bashkësi), dr. Musli Vërbani (Këshilli i Bashkësisë Islame në Kaçanik), Kjani Sallahu (Klubi i Gazetarëve të Kaçanikut), Besarta Idrizi (Asambleja Rinore e Kaçanikut), Shemsedin Abazi (KMDLNj), Ekrem Dauti (Shoqata e Zejtarëve), ndërsa sipas UA ky këshill duhet ta ketë edhe një përfaqësues të FSK-së.



# Nis projekti i pastrimit të dy përroskave të qytetit

4 maj - Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike ka filluar zbatimin e një projekti të MPSP-së dhe të Zyrës Komunale të Punësimit. Nëpërmjet këtij projekti është duke u pastruar përroska në lagjen Rakoci, ajo në rrugën “Ramadan Agushi” si dhe pastrimi i Parkut të Qytetit. Në këtë projekt janë angazhuar 14 punëtorë, të cilët do të paguhen nga buxheti i MPMS-së, ndërsa janë përzgjedhur nga lista e të papunëve në ZKP. MPMS-ja në këtë formë ka ndihmuar punësimin sezonal në Kaçanik edhe vitin e kaluar.



# Avancohet qasja e qytetarëve për marrjen e dokumenteve

6 Maj - Qytetarët të cilët kanë aplikuar për letërnjoftime, dokumente të udhëtimit dhe patentë-shofer, tani e tutje nuk kanë nevojë t'i ngarkojnë sportelet për të pyetur se a u janë bërë gati dokumentet e sipërpërmendura, por këtë mund ta konfirmojnë nëpërmjet formës digjitale duke klikuar në portalin qeveritar, përkatësisht uebfaqen e MPB-së, kanë theksuar në Qendrën e Regjistrimit Civil. Koordinator i Qendrës së Regjistrimit Civil, z. Burim Bajra ka thënë se nëse ndokush ka bërë kërkesë për letërnjoftime, dokumente të udhëtimit apo patentë-shofer të Republikës së Kosovës dhe dëshiron ta konfirmojë se dokumenti është gati për ta marrë duhet të klikojë në portalin qeveritar: http//www.rks-gov.net ose në faqen zyrtare të MPB-së: htpp//www.mpb-ks.org. Ndërkaq, z. Murtez Mema, koordinator i Zyrës së Ofiqarisë, ka theksuar se ka filluar zbatimi i Ligjit për shtetësinë 03/L-034, përkatësisht zbatimi i Udhëzimit administrativ nr. 02/2009 për regjistrimin e shtetësisë dhe i atij nr. 04/2009 për lirimin nga shtetësia, si dhe udhëzimet tjera përcjellëse për kushtet, mënyrën dhe procedurat e shtetësisë me të cilat MPB-ja i ka autorizuar shërbimet e gjendjes civile në komunë.

# Dita e Evropës shënohet me aktivitete kulturore, sportive e të diturisë

9 maj - Për nder të 9 Majit- Ditës së Evropës, janë mbajtur aktivitete të ndryshme garuese, ndërsa një manifestim qendror është mbajtur në Pallatin e Kulturës "Xheladin Kurtaj". Në këtë tubim të pranishmëve u është drejtuar me disa fjalë znj. Hidajete Guri, zyrtare për integrime evropiane në Komunën tonë. Ajo ka thënë se edhe Komuna jonë është angazhuar t'i kryejë të gjitha detyrat që dalin nga plani i veprimit për partneritet evropian Ndërkaq, kryetar i Komunës, z. Xhabir Zharku , duke u thirrur në statusin tashmë shtetëror të Kosovës ka vlerësuar se për t'u bërë pjesë e Evropës tani është më lehtë, ndërsa për këtë nevojitet një bashkëpunim dhe angazhim i të gjithë qytetarëve. Pjesë e aktiviteteve të shënimit të Ditës së Evropës ishte edhe kuisi i diturisë: "Të rinjtë dhe Evropa", kuis në të cilin garuan nga tre nxënës të dy shkollave të mesme të Kaçanikut, ndërsa garën e cila përfshinte pyetje



që lidheshin kryesisht me Bashkimin Evropian, e fituan nxënësit e gjimnazit “Skënderbeu”. Po ashtu në kuadër të këtij përvjetori është mbajtur krosi me moton "Drejtë Bashkimit Evropian". Në këtë garë në distancën ndërmjet Shkollës së Mesme Profesionale dhe Pallatit të Kulturës "Xheladin Kurtaj" janë mbajtur vrapime në konkurrencën e juniorëve në të dyja kategoritë, në atë të seniorëve si dhe të veteranëve. Në kuadër të kësaj dite është shfaqur edhe një program kulturor artistik nga SHKA-të “Gryka e Kaçanikut” dhe “Shqiponja”.

## Qeveria norvegjeze përkrahë bizneseve të vogla e të mesme

13 maj - Kaçaniku është njëra ndër pesë komunat e Kosovës e cila është përfshirë në projektin “Zhvillimi ekonomik lokal dhe qeverisja lokale”, projekt i cili implementohet nga Asociacioni i Autoriteteve



Lokale të Norvegjisë (KSN), ndërsa fondet për implementimin e projektit janë siguruar nga Ministria e Jashtme e Norvegjisë. Projekti do të përfshijë themelimin e një qendre të biznesit, bashkëpunimin me shkollat e mesme për programe me ndërmarrësit e rinj, linja kreditore për fermerë dhe biznese të vogla, trajnimin e fermerëve dhe bizneseve të vogla për hartimin e planeve të biznesit dhe ngritjen e kapaciteteve për stafin e komunës. Në funksion të kësaj në komunën tonë kanë qëndruar në një vizitë përfaqësuesit e KSN-së norvegjeze, z. Oystein Haugen, drejtor i projekteve dhe z. Bjorn Rongevaer, zyrtar, si dhe menaxherët vendor të projektit, z. Driton Ramajli dhe z. Skënder Halili. Në takimin që ka pasur me kryetarin e Komunës, z. Xhabir Zharku, drejtori i projekteve z. Oystein Haugen ka thënë se Komuna ka përmbushur obligimet e veta, ndërsa ne tani jemi në proces të përgatitjes së projekteve. Ndërkaq, kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, u ka thënë mysafirëve se Zyra e Qendrës së Bizneseve tashmë është e gatshme.

# Përkujtohet dëshmori i kombit Qamil Ilazi-Komandant Bardhi

14 Maj – Me një manifestim përkujtimor në vendin e rënies "Te Vestë" është përkujtuar në 10-vjetorin e rënies Qamil Ilazi- Komandant Bardhi, komandant i Brigadës 162 "Agim Bajrami" dhe bashkëluftëtari i tij Selim Shehu.

Fjalën e rastit në këtë manifestim e ka mbajtur z. Feriz Deda, i cili është shprehur se edhe sot përulemi në kujtim të veprës madhore të komandant Bardhit- Qamil Ilazi dhe bashkëluftëtarit Selim Shehu, ndërsa më pas ka prezantuar edhe segmente nga biografia e Komandantit të përkujtuar në këtë përvjetor. Ndërkaq, kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, në fjalën e tij ka vlerësuar se Komandant Bardhi shquhej me trimëri ndërsa ishte udhërrëfyes dhe udhëheqës i shkëlqyer. Ai ka thënë se Komandant Bardhi ishte nga ata që nga malet e Kaçanikut ftoi bashkë atdhetarët që t'iu bashkohen luftës çlirimtare dhe t'iu bashkohen fondit"Vendlindja Thërret". Dëshmorët sakrifikuan jetën e tyre për lirinë



e Kosovës, ndërsa neve na mbetet ta ndërtojmë shtetin e Kosovës, dhe vetëm kështu e qojmë në vend amanetin e tyre, ka vlerësuar kryetari Zharku. Në emër të degës së OVL-së ka përshëndetur z. Ejup Runjeva, kryetar. Të pranishmit në këtë tubim përkujtimor, në emër të familjeve të dëshmorëve i ka përshëndetur z. Besim Ilazi, ndërsa pran pllakës përkujtimore të Komandant Bardhit dhe bashkëluftëtarit Selim Shehu janë vendosur lule dhe është shfaqur një program kulturor artistik.

## Akademi përkujtimore për Qamil Ilazin - Komandant Bardhi

Prishtinë, 14 maj – I organizuar nën patronazhin e kryetarit të Komunës së Kaçanikut, z. Xhabir Zharku, në sallën e kuqe të Fakultetit Filologjik në Prishtinë është mbajtur një akademi përkujtimore në nderim të 10–vjetorit të rënies së dëshmorit Qamil Ilazi- Komandant Bardhi. Në



këtë akademi fjalë ka prezantuar kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i cili figurën e komandant Bardhit e ka portretizuar si një hero të madh, udhërrëfyes dhe si një luftëtar me vlera të larta kombëtare e ushtarake. Ai ka vlerësuar se Qamil Ilazi ishte një komandant profesional, ndërsa ishte i gatshëm gjithnjë të sakrifikohej, por edhe i bindur në fitoren e luftës së UÇK-së. Fjalën e rastit në këtë akademi e ka mbajtur z. Hajrush Kurtaj, zëvendës komandant i Brigadës 162 "Agim Bajrami". Z. Kurtaj ka thënë veç tjerash, se komandant Bardhi kishte një bazë dhe lidhje të forta koherente midis vlerave ushtarake dhe normave shoqërore e morale-patriotike.

## Përkujtohen dëshmorët e Gjurgjedellit dhe Llanishtës

14 Maj - Nën përkujdesen e kryetarit të Komunës, z. Xhabir Zharku dhe në bashkëpunim me OVL- dega në Kaçanik, në kuadër të aktiviteteve



përkujtimore në 10–vjetorin e rënies së komandant Bardhit – Qamil Ilazi me bashkëluftëtarët Selim Shehu, Ejup Dushkaja, Rizvan Bela, Xhezahir Bela dhe Sakip Mulaku, në Gjurgjedell është mbajtur një manifestim përkujtimor. Fjalën e rastit në emër të nënkëshillit organizues ka prezantuar z. Xhelil Mani, ndërsa në emër të Kuvendit të Komunës ka përshëndet kryesuesi i z. Xhelal Gashi. Në emër të Organizatës së Veteranëve të Luftës një fjalë të shkurtër e ka prezantua kryetari i kësaj organizate, z. Ejup Runjeva, ndërsa në emër të familjeve të dëshmorëve ka përshëndetur z. Ilmi Bela. Me këtë rast u shfaq edhe një program kulturor artistik dhe u vendosën lule pranë pllakës përkujtimore të dëshmorëve.

Ndërkaq, te vendi i rënies pranë pllakës përkujtimore, në fshatin Llanishtë, në 10- të vjetorin e rënies, u përkujtuan dëshmorët Hesat Axhami dhe Burhan Zeneli. Në këtë manifestim fjalë rasti prezantoi z. Sinan Zeneli, ndërsa në emër të institucioneve komunale, nënkryetari i komunës, z. Heset Loku. Nga ana tjetër, z. Vebi Koraqi, veteran i luftës ka folur në emër të OVL-së në Kaçanik. Në këtë manifestim përkujtimor në emër të familjeve të dëshmorëve ka përshëndet z. Afet Axhami. Pranë pllakës përkujtimore të dy dëshmorëve janë vendos lule dhe është shfaq një program kulturor artistik.

# Luksemburgasit ndihmojnë shkollimin e kaçanikasve

18 Maj - CARITAS- i nga Luksemburgu do të jetë dhurues i disa bursave për nxënës të shkollave të mesme, ndërsa lartësia e tyre për vitin shkollor 2009-2010 do të jetë 40 euro. Sipas kësaj organizate të drejtën e aplikimit për këtë bursë e kanë vetëm nxënësit që e kanë mbaruar klasën IX në institucionet publike arsimore, ndërsa përparësi për të qenë përfitues bursash janë: nxënësit e familjeve në nevojë, aplikuesit me aftësi të kufizuara, jetimët, aplikuesit me prindër të papunësuar, nxënësit nga mjediset rurale, minoritarët, vajzat, nxënësit me sukses të shkëlqyeshëm dhe sjellje shembullore dhe aplikuesit që vijnë nga familje të cilat shkollojnë më shumë se 3 fëmijë. Drejtori i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, z. Azem Guri, ka theksuar se bursat do të jenë në shumë prej 40 eurosh. Vlen të përmendet se "Caritasi" i Luksemburgut është mjaftë aktiv në komunën e Kaçanikut.



# Zhvillohen gara me biçikletë për filloristë

19 Maj - Në organizim të Njësitit të Komunitetit të Stacionit Policor dhe në mbështetje të Komunës, është mbajtur gara tradicionale me biçikletë e nxënësve të klasave V-IX të shkollave fillore të komunës tonë, për vitin 2009. Fitues i kësaj gare është Bunjamin Jaha nga shkolla fillore “Agim Bajrami” në Stagovë, i cili e mori medaljen e artë dhe kupën e kësaj gare. Kjo garë është zhvilluar në dy disiplina: vlerësimin e njohurive përmes testit, dhe gara me biçikletë- kalimi i shtegut, ndërsa kanë marrë pjesë 16 konkurrentë. Pesë vendet e para janë kualifikuar për garat në nivel të rajonit të Ferizajt.



# Debat për rolin dhe përfaqësimin e KKSB-së

19 Maj - OJQ-ja "Elita" nga Vitia në mbështetje të East West Managment Institute, ka organizuar të mërkurën në Kaçanik një debat me temën "Konstituimi i KKSB-së dhe nominimet nga shoqëria civile", në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësues të pushtetit lokal, policisë, OJQ-ve, komunitetit fetar dhe mediet nga komuna jonë. Koordinator i OJQ-së "Elita", z. Emrush Azemi, ka vlerësuar me këtë rast se Komuna e Kaçanikut është ndër të parat e cila e ka themeluar Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi.  Ndërkaq, nënkryetari i Komunës së Kaçanikut, z. Heset Loku, pasi i ka njoftuar pjesëmarrësit e këtij takimi se KKSB-ja në këtë komunë është konstituuar më 4 maj të këtij viti, ka sqaruar se ky



këshill përfaqësohet nga pesë anëtarë të OJQ-ve, ndërsa mbetet e hapur mundësia për përfshirjen edhe të përfaqësuesve të OJQ-ve të tjera.
Kontribut me vlerësime rreth këtij këshilli kanë dhënë edhe kryesuesi i KK-së, z. Xhelal Gashi dhe u.d. i komandantit të Stacionit Policor, togeri Jaser Jaha. Mbështetje punës së KKSB-së në këtë takim i kanë dhënë edhe z. Ejup Runjeva (OVL e UÇK-së), z. Zekirja Loku (KKK), znj. Kadrije Berisha (OJQ "Lidhja e gjallë e Kosovës"), z. Ekrem Raka e z. Kjani Sallahu (Klubi i Gazetarëve të Kaçanikut). Dëshirën për të qenë pjesë e KKSB-së e kanë shprehur edhe përfaqësuesit e OJQ-së "Lidhja e gjallë e Kosovës" dhe OJQ "Hadikos".

## Në Rodopet e Kaçanikut nis ndërtimi i një kompleksi spitalor privat

20 Maj - Në fshatin Nikoc është inauguruar gurthemeli i një projekti të rëndësisë kapitale dhe shumë të nevojshëm për qytetarët jo vetëm të kësaj ane. Në lokalitetin rural të kësaj komune ka nisur ndërtimi i një spitali, i cili është duke u financuar nga bashkatdhetari i kthyer nga Belgjika, z. Hajdin Bela nga fshati Nikoc.
Inaugurimin e punimeve të këtij projekti e kanë bërë z. Xhabir Zharku, kryetar i Komunës, z. Nasim Haradinaj, ish-komandant i luftës së UÇK-së, tani biznesmen nga Rrafshi i Dukagjinit, si dhe z. Hajdin Bela, investitor. Në këtë ceremoni përuruese, kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku ka vlerësuar se ky investim ka një rëndësi të veçantë, pasi bëhet nga një mërgimtar që tani më është kthyer për të jetuar e punuar në vendlindje. Ndërkaq ndërtuesi i këtij kompleksi spitalor, z. Hajdin Bela,

ka thënë se ky investim do të jetësohet në vitin 2011. Ai ka theksuar se në këtë spital do të trajtohen sëmundje të mushkërive, eshtrave, sëmundje kardiovaskulare dhe të tjera. Është thënë se ky investim kap vlerën e 5 milionë eurove. Investitori, z. Bela ka bërë të ditur se këtë institucion privat do ta quajë "Spital belg".



# Përkujtohet dëshmori Kemal Thaçi, rruga e fshatit merr emrin e tij

21 Maj - Në fshatin Runjevë, në 10-vjetorin e rënies është përkujtuar dëshmori Kemal Thaqi. Pranë pllakës përkujtimore, është shpalosur tabela me emrin e këtij dëshmori, me të cilin emër është emërtuar rruga e fshatit Runjevë. Shpalosjen e tabelës me emrin e dëshmorit e kanë bërë kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku dhe Naim Thaçi, djali i dëshmorit. Kryetari Zharku ka përgëzuar banorët e këtij fshati me rastin e emërtimit të rrugës me emrin e dëshmorit Kemal Thaçi. Në emër të OVL-së ka përshëndetur z. Ejup Runjeva.



# Përkujtohet dëshmori Ekrem Gudaçi dhe 13 viktimat civile

21 maj - Në Stagovë është mbajtur manifestim përkujtimor, në 10-të vjetorin e rënies së dëshmorit Ekrem Gudaqi dhe 13 viktimave të rënë në këtë ditë. Në këtë manifestim në emër të KO-së fjalë, e rastit e ka mbajtur z. Kemal Teneqja, veteran i luftës. Në emër të institucioneve komunale ka folur kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku. Ai me këtë rast ka vlerësuar se po mos të ishte gjaku i derdhur i dëshmorëve dhe lufta heroike e UÇK-së, ne nuk do të ishim sot këtu. Në emër të OVL-së ka përshëndetur kryetari i kësaj organizate z. Ejup Runjeva, ndërsa në emër të familjeve z. Basri Krivanjeva.
Me këtë rast u shfaq edhe një program kulturor e artistik.



# Përkujtohen 5 kaçanikasit e rënë në Burgun e Dubravës

22 maj – Dëshmorët Tefik Raka, Mejdi Dalloshi, Avdylgafurr Luma, Danush Kurtaj dhe Suad Brava, të rënë në Burgun e Dubravës para 10 vjetësh, bashkë me 192 të burgosur tjerë, janë përkujtuar me një akademi të mbajtur në Pallatin e Kulturës në Kaçanik. “Në botën e civilizuar të arrestuarit gjatë luftërave trajtohen sipas ligjeve ndërkombëtare, mirëpo Serbia pushtuese nuk i ka përfillur këto ligje dhe as kodin human", ka thënë kreu i Komunës, z. Xhabir Zharku, në fjalën e tij të rastit. Ndërkaq, folësi i radhës, z. Azem Guri, drejtor i DAK-së, të rënët në Burgun e Dubravës i ka cilësuar dëshmorë të kombit. "Të gjithë ne i falemi kujtimit të përjetshëm për dëshmorët e kombit të rënë në Burgun e Dubravës, në këtë plojë të pashembullt të kohëve të



reja", ka thënë z. Guri. Organizatorët e akademisë përkujtimore në emër të familjarëve të të rënëve i ka falënderuar biri i dëshmorit Mejdi Dalloshi, Artori, ndërsa kujtime nga masakra e Dubravës ka evokuar z. Hasan Dalloshi, i mbijetuar i saj.

## Zëvendësohen gypat e ujësjellësit në lagjen "Ganimete Tërbeshi"

22 Maj - Banorët e lagjes "Ganimete Tërbeshi" në lokalitetin e Dushkajës do të bëhen me rrjet të ri të ujësjellësit, përkatësisht gypat e asbestit kanë filluar të zëvendësohen me gypa standard të kualitetit të lartë. Sipas z. Enver Zharku, drejtor i Ndërmarrjes Komunale të Ujësjellësit dhe Kanalizimit "Lypeteni", gjatësia e këtij rrjeti të



ujësjellësit është 310 metra. Ai ka sqaruar se financimin e ndërrimit të këtyre gypave e bën Komuna, kurse punimet i kryen NKUK "Lypeteni". Z. Zharku ka bërë të ditur se zëvendësimi i gypave bëhet nga fakti se shumë shpejtë do të asfaltohet rruga "Ganimete Tërbeshi", në mënyrë që ajo të mos dëmtohet pas shtresimit me asfalt. Ky rrjet përfshin vendosjen e gypave me diametër më të madh se ekzistuesi, për furnizimin e mjaftueshëm me ujë të rreth 100 familjeve të lagjeve "Ganimete Tërbeshi", "Skënderbeu" dhe "Dushkaja", sa do të lidhen në këtë rrjet, ka nënvizuar drejtori Zharku.

## Lagjet Leka dhe Topalli bëhen me rrugë të asfaltuar

24 Maj - Në lagjen Leka të fshatit Doganaj dhe në atë Topalli të Soponicës, kanë filluar punimet për asfaltimin dy rrugëve, të cilat janë duke u financuar me mjete të buxhetit komunal dhe me participim të komunitetit. Në lagjen Leka është duke u asfaltuar rruga në gjatësi 864 metra dhe gjerësi 3 deri në 4 metra. Vlera e projektit të kontraktuar është 62.330 euro, prej



të cilave komuniteti i kësaj lagje ka participuar me 5.100 euro. Ndërkaq, gjatësia e rrugës në lagjen Topalli është 1 kilometër e 118 metra dhe do të shtresohet me asfalt në gjerësi 3 deri në 4 metra. Ky projekt është kontraktuar për 77.377 euro, prej të cilave komuniteti i lagjes Topalli ka participuar me 14 mijë euro, ndërsa pjesën tjetër e financon Komuna.

## Përkujtohen dëshmorët dhe të rënët e Betejës së 25 Majit

25 Maj - Në fshatin Biçec është përkujtuar Beteja e 25 Majit, gjatë së cilës dhjetë vjet më parë ranë në altarin e lirisë 7 dëshmorë dhe 9 martirë të luftës, ndërsa janë përkujtuar edhe tre dëshmorë të këtij fshati të cilët ranë më 9 prill 1999. Betejën e 25 majit e cila bashkë me të tjerat në Kosovë i dha fund sundimit serb mbi popullin shqiptar, e ka përshkruar në emër të këshillit organizues, z. Hajrush Dullovi. Manifestimin e kanë përshëndetur z. Xhabir Zharku- kryetar i Komunës, z. Berat Luzha- deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Rexhep Bunjaku- veprimtar i çështjes kombëtare, z. Ejup Runjeva- kryetar i degës së OVL të UÇK-së dhe z. Zekirja Baftiu- vëllai i dëshmorit Avdulla Baftiu. Në këtë





manifestim është shfaqur edhe një program artistik, ndërsa janë bërë homazhe dhe janë vendosur kurore me lule te të gjitha pllakat përkujtimore të dëshmorëve të rënë më 25 maj 1999, te pllaka përkujtimore e dëshmorëve të fshatit Biçec, si dhe te Varrezat e Dëshmorëve të komunës së Kaçanikut. Më 25 maj 1999 ranë dëshmorë: Avdullah Baftiu, Nazmi Osmani, Kemal Kolshi, Shaqir Kuka, Sakip Hysa, Qemajl Guri dhe Sadik Guri, ndërsa janë martirizuar edhe 9 viktima civile. Janë përkujtuar edhe dëshmorët e këtij fshati: Habit Dullovi, Fadil Bunjaku dhe Fatmir Horuni.

# Diskutohen problemet e strehimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara

29 Maj - Prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara kanë artikuluar shqetësimet dhe vështirësitë me të cilat janë duke u përballur, ndërsa janë shprehur se u është rënduar barra e jetës. Në një takim të organizuar nga shoqata "Handikos" në Kaçanik, prindërit e kësaj shtrese kanë kërkuar ndihmën e shtetit për t'ua lehtësuar vuajtjet që po i shoqërojnë ata të cilët kanë pjesëtarë të familjes me aftësi të kufizuara. Tema e këtij takimi, të mbështetur nga Komisioni Evropian dhe organizata "Save the children", ishte strehimi familjar i fëmijëve me aftësi të kufizuara, ndërsa kishte për qëllim prezantimin e projektit nëpërmjet të cilit shprehej kuptimi për strehimin familjar, shpjegimi për përgjegjësit e zhvillimit dhe strehimit familjar, identifikimi i familjeve që mund të bëhen strehues familjar dhe se cilët fëmije kane nevoje për shërbimin e strehimit familjar... Rreth 30 prindër ishin prezentë në këtë takim. Lidhur me strehimin e fëmijëve nga aspekti profesional dhe institucional, ka shpjeguar z. Ramadan Luzha, drejtor i Qendrës së Punës Sociale në Kaçanik.



# KK-ja miraton rishikimi buxhetor të pjesës së parë të vitit

29 maj - Kuvendi Komunal ka mbajtur seancë të rregullt për ta rishikuar buxhetin e gjashtëmujorit të parë të këtij viti fiskal. Diskutimi i rishikimit buxhetor të gjashtëmujorit të parë, u tha se është obliguar nga Qeveria që ta miratojmë menjëherë. Lidhur me këtë është konstatuar se buxheti i miratuar për vitin 2009 mbetet në të njëjtën shumë, ndërsa janë bërë lëvizje vetëm brenda programeve buxhetore. Kjo pikë e rendit të ditës, e cila ishte e vetmja në këtë seancë, është miratuar.



*Qershor 2009*

# Përfundon një projekt, në realizim janë 5 sish

4 Qershor - Në pesë muajt e parë të këtij viti, në komunën tonë është realizuar tërësisht faza e tretë të kanalizimit në fshatin Dubravë, investim i komunës i cili ka kushtuar 13.239 euro. Menazheri i Zyrës së Prokurimit, z. Zeqir Selmani ka thënë se në realizim e sipër është projekti i asfaltimit të rrugës në lagjen Topalli të Soponicës (nga shkolla e Dubravës deri te lagjja Topalli), projekt i cili është kontraktuar për 77.377 euro, prej të cilave 14 mijë euro i ka grumbulluar komuniteti, ndërsa të tjerat Komuna. Sipas tij, njëkohësisht është duke u realizuar edhe asfaltimi i rrugës në lagjen Leka të Doganajve, e kontraktuar për 62.330 euro, prej të cilave 5 mijë euro i kanë dhënë banorët dhe pjesën tjetër Komuna. Po ashtu ka bërë të ditur z. Selmani, kanë nisur punimet në asfaltimin e fazës së dytë të rrugës së fshatit Bob, të cilin e financon tërësisht Komuna dhe është kontraktuar për 49.863 euro. Menaxheri i prokurimit ka përmendur edhe projektin në ndërtim e sipër të bustit të dëshmorit Ismail Raka dhe të pllakës përkujtimore të viktimave civile



të luftës (19.863 euro), i cili është financim i Komunës, si dhe bustit të veprimtarit Sali Bajra, ish-kryetar i Kaçanikut (7.914 euro). Ndërkaq, kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku ka thënë se projektet të cilat janë në listën e prioriteteve për sivjet do të realizohen. Kryetari z. Zharku ka siguruar se aq sa do të kenë mjete Komuna dhe komuniteti do të realizohen projektet që janë në listën prioritare, ndërsa sasia e mbetur e projekteve do të shndërrohet në faza të implementimit dhe do vazhdojnë të përmbyllen vitin e ardhshëm.

## Vendosen kamera vëzhguese në objektin e Administratës Komunale

5 Qershor - Kuadrati i objektit të Administratës Komunale të Kaçanikut bashkë edhe me oborrin e saj është futur nën monitorimin e kamerave vëzhguese, të cilat do t'i përcjellin të gjitha lëvizjet në këto hapësira. Janë vendosur 9 kamera monitoruese të lëvizjeve në hapësirat e brendshme dhe të jashtme të objektit të Komunës, të cilat janë në funksion 24 orë pandërprerë, ka pohuar z. Xhabir Zharku, kryetar i Komunës. Sipas tij, ky projekt është financuar nga mjetet e buxhetit komunal, ndërsa ka kushtuar 8.047 euro. Kryetari Zharku ka thënë se në këto kamera ka qasje kryetari dhe



nënkryetari i Komunës si dhe Zyra e Teknologjisë Informative. Kamera për monitorimin e lëvizjeve janë vendosur në Zyrën e Pritjes, nëpër korridore dhe jashtë objektit të Administratës Komunale.

## Hiqen mbeturinat përgjatë magjistrales

5 qershor - Për nder të Ditës Botërore të Mjedisit të premten ka filluar të realizohet projekti për pastrimin e mjedisit dhe heqjen e hedhurinave përgjatë rrugës magjistrale që përshkon komunën e Kaçanikut. Për kryerjen e këtyre punëve të këtij projekti, i cili do të zgjasë 8 ditë, janë angazhuar gjithsej 6 punëtorë. Sipas Hajrush Dullovit, zëdhënës i Komunës së Kaçanikut, punëtorët e angazhuar do të marrin nga 13 euro mëditje, ndërsa projekti është duke u realizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Zyrës Komunale për Punësim dhe Komunës së Kaçanikut.



# Komuna krijon hapësirë të veçantë për legjislativin

5 Qershor - Në objektin e Administratës Komunale sivjet do të nis ndërtimi i një kati komplet mbi objektin ekzistues, i cili do t'i shërbejë nevojave ekskluzive të KK-së. Ky kat do ta ketë sallën e mbledhjeve të KK-së, zyrat për të gjithë stafin e KK-së dhe hapësirat e nevojshme përcjellëse të legjislativit, ka thënë kryetari i Komunës z. Xhabir Zharku, sipas të cilit është studiuar qëndrueshmëria dhe është konstatuar se objekti i AK-së mund t'i përballojë jo vetëm këtij kati. Për këtë projekt Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal i ka ndarë 90 mijë euro, ndërsa shumën tjetër të nevojshme do ta plotësojë me mjetet e veta buxhetore Komuna, ka nënvizuar kryetari Zharku. Pas luftës, KK-ja mbledhjet i ka mbajture në objektin e Shtëpisë së Mallrave, ndërsa tani seancat i mban në një hapësirë të improvizuar të Pallatit të Kulturës. Në kushtet dimërore, për shkak të mungesës së nxehjeve dhe temperaturave të ulëta, seancat e KK-së janë mbajtur edhe në objektin shkollor të gjimnazit "Skënderbeu" dhe në një sallë të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare.



# MASHT-i financon ndërtimin e shkollës nëntëklasëshe në Dushkajë

8 Qershor - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë do të financojë ndërtimin e shkollës nëntëklasëshe në lokalitetin Dushkajë të komunës së Kaçanikut, ka theksuar z. Xhabir Zharku, kryetar komune. Kryetari Zharku ka thënë se ky objekt shkollor do t'i ketë 11 dhoma mësimi dhe ambientet tjera përcjellëse, ndërsa projekti do të kushtojë në vlerë rreth 600 mijë euro. Ndërtimi i kësaj shkolle është premtim të cilin e pat dhënë ministri i MASHT-it, z. Enver Hoxhaj, në maj të vitit të kaluar, në një vizitë që i pat bërë komunës tonë.



# Mbahet Festivali i XXI i SHAKA "Kaçaniku 2009"

11 Qershor - Ansambli Folklorik "Shotë Galica" nga Drenasi është shpallur fituese e Festivalit XXI kombëtar të SHKA-ve dhe Ansambleve Artistike "Kaçaniku 2009", ngjarje kulturore kjo e cila është tradicionale, ndërsa e mbajtur në qershor i ka shtuar begatinë manifestimeve për Ditën e Çlirimit të Kaçanikut. Çmimin e dytë të këtij festivali e ka fituar Ansambli i Këngëve dhe Valleve "Rrajca" nga Librazhdi i Shqipërisë, ndërsa vendin e tretë e ka zënë SHKA "Xha Rexha" nga Zajazi i Maqedonisë. Këto ishin vendimet e jurisë profesioniste të festivalit, ndërsa vlerësimi i publikut për prezantimin e programit më të mirë ka shkuar në Luginën e Preshevës, përkatësisht te "Rexho Mulliqi" nga Presheva. Rastësia e epilogut garues të këtij



festivali ishte se të tre çmimet e fituara ishin të shoqërive të cilat shfaqën programin e tyre në mbrëmjen e dytë të festivalit. Festivali XXI Kombëtar i SHKA-ve dhe AA-ve “Kaçaniku 2009” është mbajtur tri ditë radhazi në Kalanë e Kaçanikut. Kjo ngjarje kulturore është organizuar nga Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës dhe nën patronazhin e kryetarit të Komunës së Kaçanikut. Në festivalin XXI të SHKA-ve dhe AA-ve kanë marrë 9 SHKA dhe ansamble të tjera nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Lugina e Preshevës: SHKA”Rexho Mulliqi” (Preshevë), Grupi Artistik i Qendrës Kulturore të Ulqnit, AF ”Shotë Galica” (Drenas), SHKA ”Xha Rexha” (Zajaz), SHKA ”Kemajl Azizi” (Viti), AKV ”Rrajca“ (Librazhd), SHR ”Hivzi Sylejmani” (Prishtinë), SHKA-të kaçanikase “Gryka e Kaçanikut” dhe “Shqiponja”, por të cilat programin e tyre e kanë shfaqur jashtë pjesës garuese të këtij festivali, ndërkohë që ndonëse e kishin konfirmuar pjesëmarrjen, nuk kanë ardhur fare Trupa Artistike e Ansamblit të Këngëve e Valleve të Gjilanit dhe GP ”Himara” (Himarë).

# Marshi i ish-ushtarëve të Brigadës 162 të UÇK-së "Agim Bajrami"

11 Qershor - Në orët e pasdites ushtarë të Brigadës 162 të UÇK-së "Agim Bajrami" ka në marshuar nëpër rrugët e qytetit, duke simbolizuar hyrjen triumfale në qendrën e qytetit pikërisht para dhjetë viteve. Në bulevardin " Ismal Raka", të rreshtuar dhe të prirë nga ish-komandanti kësaj brigade, z. Xhabir Zharku, tani kryetar i Komunës, ish-ushtarët e kanë vendosur flamurin kombëtar mbi ndërtesën tetëkatëshe në bulevardin "Ismajl Raka", pikërisht në vendin ku ushtarët e kësaj brigade e kishin vendosur atë më 11 qershor 1999.



# Kremtohet përvjetori jubilar i Ditës së Çlirimit

11 Qershor - Për nder të Ditës së Çlirimit të Kaçanikut, Kuvendi Komunal ka mbajtur mbledhje solemne. Fjalën e rastit e ka mbajtur kryesuesi i KK-së, z. Xhelal Gashi, i cili ka përshkruar shkurtimisht historikun e viteve '98-'99, gjatë të cilave me mbështetjen e botës demokratike në krye me SHBA-në dhe NATO-n, janë larguar forcat pushtuese serbe nga Kosova. Ai dekadën e fundit e ka cilësuar si historike, për faktin e pavarësimit të vendit tonë. Z. Gashi ka vlerësuar se tani nga ne duhet punë e përhershme për ndërtimin e një administrate efikase dhe zhvillimin e shoqërisë në të gjitha sferat e jetës, ndërsa kujtimi për ata që dhanë jetën për liri duhet të na shërbejë si frymëzim për punë dhe angazhime të reja. Këtë mbledhje



solemne e ka përshëndetur kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku. Para kësaj seance janë bërë homazhe te Varrezat e Dëshmorëve të komunës së Kaçanikut, ndërsa në orët e vona të pasditës është mbajtur manifestimi qendror për Ditën e Çlirimit të komunës tonë.

## Komuna shtron darkë për mësimdhënësit, merr pjesë edhe kryeministri Thaçi

12 Qershor - Komuna ka organizuar një darkë për të gjithë mësimdhënësit e komunës tonë, ndërsa ishte prezentë edhe kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi dhe ministri i Arsimit, Shkencës e Teknologjisë, z. Enver Hoxhaj. Me këtë rast kryeministri z. Thaçi ua ka përsëritur premtimin mësimdhënësve të Kosovës se gjatë këtij mandati të Qeverisë së tij do t'u rriten pagat edhe njëherë. Kreu i



ekzekutivit të vendit, z. Hashim Thaçi ka premtuar gjithashtu se, ndryshe nga viti  kaluar, ku me tekste mësimore falas nxënësit janë pajisur nga klasa I-V, sivjet janë planifikuar tekste shkollore falas për të gjithë nxënësit nga klasa I-IX. Ndërkaq, z. Enver Hoxhaj, ministër i Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë, punonjësit me ditarë shkolle në Kaçanik dhe Han të Elezit i ka cilësuar si elita më e rëndësishme. Nga an tjetër, kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku ka konfirmuar se MASHT-i është duke i mbajtur premtimet e dhëna vitin e kaluar, ndërsa për sivjet ka futur në agjendën e investimeve ndërtimin e shkollës nëntëklasëshe në Dushkajë, shkollës pesëklasëshe në Vataj të Epërm si dhe ndërtimin e aneksit të objektit të shkollës fillore në fshatin Nikaj. Vlera financiare e këtyre projekteve sillet rreth 900 mijë euro. Në 12 shkolla fillore dhe 2 të mesme të komunës së Kaçanikut punojnë 425 mësimdhënës, ndërsa në pesë shkolla fillore dhe një të mesme të Hanit të Elezit punojnë 100 sish. Mysafirëve nga Qeveria dhe Parlamenti i Kosovës kreu i Komunës i ka nderuar me emblemën e Kaçanikut.

# Diskutohen angazhimet dhe detyrat e institucioneve në procesin e integrimeve

15 qershor - Në organizim të Klubit të Gazetarëve të Kaçanikut dhe në mbështetje të Komunës, është mbajtur një debat me temën "Kaçaniku dhe vlerat evropiane", debat në të cilin kanë marrë pjesë zyrtarë të lartë të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Prishtinë, ata të pushtetit lokal, subjekteve politike të përfaqësuara në KK, OSBE-së, të OJQ-ve dhe të mediave lokale. Në këtë debat nga Komisioni Evropian ka referuar Emmanuel Cohen Hadria, këshilltar politik dhe ekonomik i sektorit të Integrimeve në Bashkimin Evropian nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Prishtinë, i cili ka bërë një prezantim gjeneral rreth mekanizmave të integrimeve në BE të shteteve të Ballkanit



Perëndimor, rajon në të cilin bën pjesë edhe Kosova. Ndërkaq nga Zyra e OSBE-së në Kaçanik ka folur znj. Julie Woloshin, e cila ka prezantuar vlerat evropiane dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. Se çfarë ka bërë Komuna në drejtim të realizimit të detyrave komunale në planin e integrimeve evropiane ka folur znj. Hidajete Guri, koordinatore e Zyrës Komunale për Integrime Evropiane. Kontribut në vlerësimin e të arriturave të deritanishme të Komunës në këtë drejtim, por edhe të çështjeve që duhet të përmbushen në të ardhmen, kanë dhënë edhe z. Heset Loku, nënkryetar i Komunës, z. Xhelal Gashi, kryesues i KK-së, Barije Çaka (PDK), Fevzi Dogani (LDK), Shukri Luta (AAK), Rami Çaka (ORA), Elmihane Krasniqi (HANDIKOS)... Në fund të këtij diskutimi është themeluar Grupi këshillëdhënës-monitorues i cili do ta mbështesë Zyrën Komunale për Integrime Evropiane në Kaçanik, në avancimin e procesit të mëtutjeshëm të integrimeve. Ky grup do të udhëhiqet nga koordinatorja e ZKIE-së, ndërsa do të përfaqësohet edhe me 4 përfaqësues të shoqërisë civile.

## Publikohen rezultatet e provimit shtetëror të maturës

15 Qershor - Provimin e maturës nga gjimnazi "Skënderbeu" e kanë kaluar 30.2 për qind të maturantëve, ndërsa nga Shkolla e Mesme Profesionale provimin e kanë dhënë 26.6 për qind e maturantëve, ka thënë z. Avni Krasniqi, zyrtar i arsimit. Sipas tij, mesatarja e përgjithshme e provimit shtetëror të maturës për maturantët kaçanikas është 28.4 për qind. Ai ka sqaruar se nga gjithsej 449 maturantë, prej tyre 278 të SHMP-së dhe 171 të gjimnazit "Skënderbeu", këtë test e kanë kaluar gjithsej 113 maturantë, prej tyre nga SHMP-ja kanë kaluar 74 maturantë, kurse nga gjimnazi 39 sish.

# Komuna i mbron vendimet e veta

19 Qershor - Është mbajtur seanca e gjashtë me radhës e legjislativit komunal, në të cilën është rishqyrtuar vendimi i KK-së për shkëputjen e Njësisë komunale të ujit dhe kanalizimit nga ndërmarrja publike rajonale "Bifurkacioni" me seli në Ferizaj. KK-ja, në mbledhjen e dytë të rregullt, të mbajtur më 27 shkurt pati marr vendim unanim për shkëputjen e NKUK-së nga KRUK "Bifurkacioni" të Ferizajt. KK ka rikonfirmuar se vendimi i saj është në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Po ashtu është zhvilluar debat lidhur me shkresën tjetër të MAPL-së, për rishikimin e vendimit të KK-së për lejimin e lokacionit për ndërtimin e objektit kolektiv të banimit me lokale afariste. MAPL-ja kërkesën për rishikim e kishte mbështetur në një kërkesë që i është adresuar asaj nga Shoqata e Zejtarëve të Kaçanikut. Në bazë të dokumentacionit që posedon Komuna, lokacioni i dedikuar për ndërtimin e objektit është pronë komunale, prandaj anëtarët e KK-së qëndruan pranë vendimit të marrë më 23.10.2008. Për shkak se nuk ka kaluar propozimi i tyre që në mbledhje të rishqyrtohet vendimi i KK-së, ashtu siç ka kërkuar MAPL-ja, 12 këshilltarë të partive opozitare, nga 14 sa ishin të pranishëm, e kanë braktisur seancën.



# Zv. ministri Dedaj premton angazhim për objektin e banimit social

24 qershor – Zëvendësministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Gjergj Dedaj, ka qëndruar në Kaçanik, ndërsa ka deklaruar se do ta shqyrtojë seriozisht kërkesën e artikuluar nga pushtetarët komunalë lidhur me nevojën e ngutshme për financimin e një objekti social të banimit kolektiv për të pastrehët e Kaçanikut. Zv.ministri i MPMS-së nuk ka dhënë premtim të prerë lidhur me këtë investim, mirëpo është zotuar se do të angazhohet maksimalisht për realizimin e këtij projekti", ka thënë z. Heset Loku, nënkryetar komune, nikoqir i Dedajt. Ndërkaq, z. Hajrush Dullovi, zëdhënës i KK-së, ka bërë të ditur se paraprakisht mysafirit me shifra i është shpalosur gjendja aktuale sociale në Komunën e Kaçanikut. Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, z. Misim Sopa, i ka thënë z. Dedaj se në Zyrën Komunale të Punësimit në Kaçanik janë të evidencuar gjithsej 8.500 punëkërkues, ndërsa 681 familje janë në asistencë sociale.



# Krerët komunalë "inspektojnë" punimet e projektit të rrugëve në Dushkajë

26 qershor - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku i shoqëruar edhe nga nënkryetari z. Heset Loku dhe drejtori i Arsimit, z. Azem Guri, i kanë bërë një vizitë disa segmenteve të asfaltuara të projektit të rrugëve të lokalitetit Dushkaja në Kaçanik. Krerët komunalë janë ndarë të kënaqur nga punët e realizuara deri tani në këtë rrugë. Gjatësia totale e rrugëve të cilat do të mbulohen me asfalt është 4.415 metra. Ky projekt përmban rrugën kryesore prej gjimnazit "Skënderbeu" dhe përshkon të ashtuquajturin kurriz të Dushkajës e deri në mbarim të saj, në gjatësi 1.803 metra dhe gjerësi 5 metra, si dhe rrugët dytësore "Ganimete Tërbeshi" në gjatësi 304 metra dhe gjerësi 3 metra, rruga prej "Urës së Hazirit" - KIS-it e deri në fund të kësaj rruge të banueshme e cila ka gjatësinë 1.041 metra dhe gjerësi 3 metra, një pjesë e rrugës "Remzi Zharku" në gjatësi 537 metra dhe gjerësi 3 metra, rruga nga KIS-i e cila lidhet me të ashtuquajturin kurriz të Dushkajës në gjatësi 295 metra si



dhe dy krahë të rrugës që lidhen me kurrizin e kësaj lagjeje në gjatësi 432 metra dhe gjerësi 3 metra. Ky projekt është financuar nga MTPT-ja (830 mijë euro), ndërsa kanë participuar edhe Komuna me 29.410 euro, përkatësisht komuniteti 20.590 euro. Kontrata e nënshkruar me kompaninë ARFA për realizimin e këtij projekti "peshon" 871.152 euro.

## Testi i arritshmërisë së nxënësve të klasave të nënta

26 qershor - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i shoqëruar nga nënkryetari, z. Heset Loku dhe drejtori i Arsimit dhe Kulturës, z. Azem Guri, kanë vizituar dy shkollat e mesme, në të cilat po mbahej testi i arritshmërisë për nxënësit e klasave te nënta.

Testit iu kanë nënshtruar gjithsej 865 nxënës nga 12 shkolla fillore të komunës së Kaçanikut, ndërsa janë vëzhguar nga 66 administratorë dhe komisionet e përbëra nga zyrtari i MASHT, zyrtarë nga DKA-ja dhe drejtorët e dy shkollave të mesme. Rezultatet e testit do të publikohen më 1 korrik.



# Ministri Vehapi vizitoi fermerin e subvencionuar nga MBPZhR-ja

29 qershor - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Idriz Vehapi dhe shoqërues të tjerë të kësaj ministrie, kanë qëndruar në komunën tonë, ndërsa kanë vizituar NPB "Koxha", përkatësisht serën e cila është ngritur sivjet nga fermeri z. Zylfi Koxha. Kjo serë fermerit i kishte kushtuar 10 mijë euro, 30 për qind të investimit e të cilit e kishte subvencionuar MBPZhR-ja. Ministri Vehapi ka rikonfirmuar këtë fakt, ndërsa ka premtuar për vitin e ardhshëm se fermerët e ndërmarrjeve ekzistuese dhe ata që do të hapin ferma të reja, ministria të cilën e drejton ai do t'i subvencionojë me 50 për qind të investimit total. Ministri Vehapi është shoqëruar në këtë vizitë edhe nga krerët komunal të Kaçanikut. Atë e ka falënderuar kryetari i Komunës, z.



Xhabir Zharku, i cili këtë përkrahje të ministrisë e ka cilësuar si mundësi reale për nxitjen e hapjes së fermave të reja në këtë komunë. Kryetari Zharku, veprimtarinë e fermerit Koxha, i cili prodhon të gjitha llojet e perimeve më të tregtuara në vendin tonë, e ka cilësuar si shembull të mirë për ofrimin konsumatorëve prodhime vendore.

## Krerët komunalë inspektojnë punimet e disa projekteve në realizim e sipër

30 qershor - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i shoqëruar nga nënkryetari, z. Heset Loku, kryesuesi i Kuvendit Komunal, z. Xhelal Gashi dhe bashkëpunëtorë të tjerë, kanë inspektuar ecurinë e realizimit të disa projekteve infrastrukturore të cilat aktualisht janë duke u realizuar ne komunën tonë.



Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku gjatë kësaj turneje fillimisht ka vizituar vendpunishten e ndërtimit të rezervuarit të ujësjellësit për fshatrat Begracë dhe Kaçanik i Vjetër. Për realizimin e projektit të përbashkët të ujësjellësit për këto dy fshatra paraprakisht është nënshkruar një marrëveshje e përbashkët mes donatorit CDI-së (Community Development Initiatives), Komunës, komuniteteve nga Kaçaniku i Vjetër e Begraca dhe Kompanisë Rajonale të Ujit dhe Kanalizimit "Bifurkacioni". Në realizmin e këtij projekti CDI-ja ka dhuruar 112.500 euro, Komuna me 75.000 euro dhe dy komunitetet me nga 31.250 euro.

Kryetari Zharku ka vizituar gjithashtu edhe vendpunishten e ndërtimit të shkollës fillore në Begracë, projekt i cili financohet nga Ministria e arsimit. Po ashtu, udhëheqësit komunalë kanë inspektuar edhe punimet e ndërtimit të trotuarit për këmbësor nga vendi i quajtur "Picërrak" e deri në Doganaj. Gjatësia e këtij trotuari është 758 metra, ndërsa vlera investuese është 28.653 euro. Kryetari më pas ka inspektuar edhe punimet në asfaltimin e fazës së dytë në fshatin Bob. Faza e dytë ka gjatësinë 450 metra dhe gjerësi 5 metra, ndërsa vlera investuese është 49.863 euro.

# Mbahet debat publik me qytetarë

30 qershor - Në objektin e Pallatit të Kulturës "Xheladin Kurtaj", me qëllim të informimit dhe pjesëmarrjes së gjerë dhe aktive të publikut dhe në pajtim me ligjet në fuqi, Komuna ka organizuar debat publik me qytetarë. Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku duke hapur debatin tha se organizimi i këtij debati është edhe një rast i mirë që të jemi sa më afër qytetarëve tanë. Kreu komunal u ka thënë të pranishmëve se ju mund t'i përcillni aktivitet e komunës edhe përmes Ueb faqes zyrtare, por organizimi i këtij debati është rast i mirë që edhe ju të bëheni pjesë e proceseve në komunën tonë. Kryetarit, z. Xhabir Zharku iu parashtruan një mori pyetjesh, ndërsa kryetari u përgjigj në secilën pyetje veç e veç.



Të gjitha projektet të cilat i ka miratuar KK-ja do të dalin në tender, ndërsa do të realizohen në përputhje me mundësitë buxhetore që ka Komuna, i është përgjigjur pyetjes së z. Kjani Sallahu, kryetari i Komunës së Kaçanikut, z. Xhabir Zharku, i cili ka sqaruar se duke shpresuar në ndihmën e donacioneve nga Qeveria për sivjet kemi paraparë edhe projekte me vlera të mëdha financiare. Kryetari Zharku, duke iu përgjigjur interesimit të znj. Sevdie Shehu, ka rikonfirmuar mbështetjen e MASHT-it për realizimin e projekteve të infrastrukturës shkollore, duke thënë se kjo ministri ka premtuar se gjatë këtij viti do të realizojë projektin e shkollës nëntëklasëshe në Dushkajë, pastaj shkollën pesëklasëshe në Vatë, aneksin e shkollës në Nikaj, por do ta financojë edhe aneksin e Shkollës së Mesme Profesionale. Në pyetjen e z. Daut Shehut se kujt do t'ia dedikoni 45 mijë dollarët e fituar nga granti i USAID-it për tatimin në pronë, kryetari ka thënë se ato mjete janë caktuar për ndërtimin e urës mbi lumin Neredime, përkatësisht do t'i shtohet edhe një krah urës ekzistuese të "Urës së Konakut", për qarkullim më të lirë të automjeteve dhe qytetarëve. Qytetari z. Shefki Guri ka shtruar pyetjen se pse nuk futen nën mbikëqyrjen e ndërmarrjes së ujësjellësit të gjithë rrjetet e ujësjellësve nëpër fshatra, në mënyrë që të mbikëqyret dhe mirëmbahet kualiteti i ujit të pijes. Për këtë numri një i Kaçanikut ka theksuar se duhet fillimisht të bëhet një marrëveshje e komunitetit të fshatrave përkatëse me kompaninë për vendosjen e ujëmatësve. Ndërkaq, z. Beqir Krasniqi nga Kaçaniku i Vjetër, ka komentuar punën e zyrtarëve të Zyrave të Vendit, sipas të cilit për çdo ditë ata duhet të shkojnë në administratën komunale për t'i mbaruar kërkesat e aplikuesve për dokumente personale. Lidhur me këtë, nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku ka theksuar se dokumentet të tilla momentalisht jepen vetëm në Kaçanik dhe ka shtuar se është

bërë përpjekje për të tejkaluar këto vështirësi. Ai ka thënë se pritet të bëhet lidhja e rrjetit dhe se këto shërbime do të kryhen edhe në zyrat e vendit. Qytetari, z. Ekrem Dullovi është interesuar të dijë se a do të shtohet orari i punës i Zyrës së Ofiqarisë në sezonin e ardhjes së mërgimtarëve për pushime, ndërsa kjo ka marrë një përgjigje pozitive nga kryetari z. Zharku, i cili ka saktësuar se orari shtesë do të aplikohet më 6 korrik. Përgjigje për çështjet me interes për qytetarët nga krerët komunalë kanë kërkuar edhe: z.Ramadush Osmani (Elezaj), z.Kemal Murseli (Doganaj), z.Abedin Vishi (Kaçanik i Vjetër), z.Nexhadi Luta (Ivajë), z.Muharrem Ahmetaj (Kovaçec), ndërsa interesimit të tyre u janë përgjigjur edhe z. Azem Guri e z. Fikri Vërbani, drejtorë të drejtorive komunale.

# Dokumente 2009

Kryetari i Komunës paralajmëron masa për të rritur transparencën

# Objekti i Kuvendit të Kaçanikut do të mbikëqyret me kamera

"Në kuptim të shtimit të transparencës, por edhe vëzhgimit, kohë vit do të instalojmë kamera vëzhguese në zyrën e pritjes, në korridore dhe në hyrje të objektit", ka bërë të ditur të enjten Zyra e Informimit të Komunës së Kaçanikut



Zyrtarët e DAP së paralajmërohen se do të vëzhgohen nga kamerat



S'E LËSHOJMË KAÇANIKUN



Sivjet mbi 2,7 milionë euro investime

KOSOVË

Intervistë me Zhabir Zharkun, kryetar i Komunës së Kaçanikut

# Kaçaniku ka bërë shumë për lirin[ë] pavarësinë e Kosovës



Dani Shehu

# Drejtoria e Urbanizmit me masa parandaluese ndaj ndërtimeve ngufatëse në Kaçanik

# Vija ndërtimore strikte ndërmjet pronës publike dhe asaj private

**Me propozimvendim është paraparë ndalimi i ndërtimeve në distancë prej 10 metrash nga vija ku prona publike kufizohet me atë private**

*Ekrem Raka*

KAÇANIK, 25 SHKURT - Pronarët e parcelave që kufizohen me rrugët Kaçanik-Doganaj dhe Fushë e Pajtimit-Kaçanik i Vjetër-Begracë do të mund të ndërtohen vetëm në një distancë prej së paku 10 metrash nga vija, e cila pronat e tyre i ndanë nga ajo publike. Drejtoria e Urbanizmit ia ka adresuar për shqyrtim dhe miratim legjislativit komunal propozimvendimin për ndalimin e ndërtimeve përskaj të dyja anëve të këtyre rrugëve deri në miratimin e Planit zhvillimor të Komunës së Kaçanikut dhe atij Urbanistik të qytetit Kaçanik. "Vijat ndërtimore janë caktuar për rrugën Kaçanik-Doganaj, nga Përroi i Kukajve e deri tek ura mbi Lepenc në fshatin Soponicë, e gjatë rreth 6 km, dhe për atë nga Fusha e Pajtimit deri te rruga Gerlicë-Viti, e gjatë rreth 6 km", ka theksuar Fatos Kosha, zyrtar i Urbanizmit, të mërkurën. Ai ka saktësuar se është paraparë ndalimi i ndërtimeve në distancë prej 10 metrash nga vija ku prona publike kufizohet me atë private. Punimet për asfaltimin e segmentit Kovaçec-Soponicë të rrugës Bob-Doganaj kanë nisur vjet, në shtator, ndërsa rruga Fushë e Pajtimit-Kaçanik i Vjetër-Begracë është asfaltuar, më 2005. "Caktimi i vijave ndërtimore përskaj këtyre dy rrugëve është bërë me qëllim të parandalimit të ndërtimeve aty deri në hartimin e Planit zhvillimor të Komunës së Kaçanikut dhe atij urbanistik të qytetit Kaçanik", ka theksuar Kosha. Ai ka pohuar se është shtuar numri i kërkesave për ndërtime përskaj atyre segmenteve. Në këtë rrafsh, është rikujtuar se byroja projektuese



Urbanizmi ia ka adresuar për shqyrtim dhe miratim legjislativit komunal propozimvendimin për ndalimin e ndërtimeve përskaj rrugëve deri në miratimin e Planit Zhvillimor

"Data Gis Consulting", me seli në Prishtinë, është kontraktuar ndërkohë për hartimin e planeve zhvillimore urbane, ndërsa ato pritet të jenë gati pas tetë muajsh. Lidhur me propozimvendimin e sipërpërmendur DU-së nuk janë dëgjuar vërejtje nga pozita dhe opozita në mbledhjen e fundit të Komitetit të Politikës dhe Financave të KK-së. "Shih për këtë, besoj se ky vendim do të miratohet në formën e propozuar edhe nga legjislativi komunal", ka artikuluar bindjen e tij Kosha, zyrtar i DU-së.

Administrata komunale e Kaçanikut mban të hapura dyert e arkivit për qytetarët

# Komuna: Asnjë qytetari nuk i është mohuar e drejta e qasjes në dokumente zyrtare

Prej themelimit të Zyrës për ankesa, më 14 shkurt 2005, e deri tani, asnjë qytetar nuk është ankuar se i është mohuar e drejta për qasje në dokumentet zyrtare, ka thënë Hajredin Dullovi, zëdhënës i Komunës së Kaçanikut

Kjani Sallahu

[illegible]



Komuna - e hapur për qytetarët për qasje në dokumentet zyrtare

### Serbët zojnë "misit" shqiptarë për qasje në dokumentet e tyre

[illegible]

### Viti 2008 - kërkesa për verifikimin e 95 dosjeve

[illegible]

Kryetari i Skënderajt realizon … të fshatrave …

## Edhe pak d… fshatrat e Dre… me rrugë të…

Deri sa kryetari i komunës, Sam… Abdyl Ymeri, i ka siguruar pe… jektet me projektet të komunës … realizohen që nga ky muaj, d… propozuar projekte të tjera, pr…

Kajtaz Gecaj

[illegible]

Pse lëvdohet e pse ankohet d… Gjakov…

## Ku e di Ministria … cialistësh n…

Vjollca Tytyni

[illegible]






